

C1-EU-NPA

CLUSTER ONE EU NEGOTIATIONS PLATFORM – ALBANIA



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



Dokument Qëndrimesh
**DRITËHIJET DHE EFEKTET
E HARTËS SË RE GJYQËSORE**



C1-EU-NPA

CLUSTER ONE EU NEGOTIATIONS PLATFORM – ALBANIA



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Dokument Qëndrimesh

DRITËHIJET DHE EFEKTET E HARTËS SË RE GJYQËSORE

8 Shkurt 2023

Ky publikim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) është realizuar në kuadër të projektit C1 – EU – NPA, “Përmirësimi i Debatit mbi Politikën dhe Llogaridhënien për të Përbushur të Drejtat Bazike, përmes krijimit të Platformës së Negociatave të Cluster 1 Shqipëri”, zbatuar nga katër organizata shqiptare, Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Instituti për Studimet Politike dhe Instituti Shqiptar i Shkencës, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Tiranë.

Mendimet e shprehura në këtë dokument janë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit dhe organizatave zbatuese.

Përgatitën dokumentin:

Av. Erida Skëndaj, *Drejtoresh Ekzekutive e Komitetit Shqiptar të Helsinkit*

Asistuan:

Znj. Enegrida Bënja, *Asistente Projektsh/Juriste*

Znj. Eriselda Ndreca, *Asistente Projektsh/Paraligjore*

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII-te, Pallati “Tekno Projekt”Shk. 2 Ap. 10, Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752Tel: 04 2233671

Mob: 0694075732

E-mail: office@ahc.org.al

website: www.ahc.org.al

Përmbajtja

Lista e Shkurtimeve	6
Hyrje	7
Përmbledhje ekzekutive	8
1. Standardet Ndërkombëtare për Aksesin në Drejtësi	11
2. Rekomandimet e Komisionit Evropian në kuadër të procesit të integrimit në BE, të vendit tonë	14
3. Dritë hijet e procesit të vlerësimit të hartës së re gjyqësore në vendin tonë	15
3.1 Standartet për “Gjykatën e krijuar me ligj”	15
3.1.1 Transparenca dhe gjithëpërfshirja	15
3.1.2 Kriteret e tjera Ligjore	16
4. Hartat Gjyqësore të vendeve të tjera (Modeli i Portugalisë)	22
4.1 Vështrim në Modelin e Hartës Gjyqësore në Portugali	22
5. Vlerësim i procesit të zbatimit në praktikë të ri-organizimit të ri gjyqësor në vendin tonë	27
5.1 Analizë e veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse	27
5.2 Veprimtaria e KLGJ-së	28
5.0.1 Urdhëri nr.80, dt.28.07.2022 të Kryetares së KLGJ-së	28
5.0.2 Plani i Veprimit për Gjykatat e Apelit	29
5.0.3 Korrespondenca e munguar e KLGJ-së me institucionet, për zbatimin e hartës së re gjyqësore	30
5.0.4 Kopjet e procesverbaleve të GNP	30
5.0.5 Aktet e miratuara nga KLGJ për jetësimin e hartës së re gjyqësore	31
6. Analizë e qëndrimeve të Gjykatave që preken nga riorganizimi i ri gjyqësor	39
Bibliografi	43

Lista e Shkurtimeve

BE - Bashkimi Evropian

CEPEJ - Komisioni Evropian për Eficencën në Drejtësi

GjEDNj - Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut

GjDBE - Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian

GJKKO - Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

GNP – Grupi ndërinstytucional i punës

ILD – Inspektori i Lartë i Drejtësisë

KiE -Këshilli i Evropës

KL Gj – Këshilli i Lartë Gjyqësor

KLP – Këshilli i Lartë i Prokurorisë

KE - Komisioni Evropian

KEDNj - Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut

KShH - Komiteti Shqiptar i Helsinkit

VKM -Vendim i Këshillit të Ministrave

HYRJE

Reformimi i sistemit të drejtësisë i realizuar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, erdhi si një nevojë për të luftuar korrupsionin në vend dhe njëkohësisht për të forcuar pavarësinë e sistemit gjyqësor, për të rritur llogaridhënien dhe eficiencën e tij, me qëllim që qytetarët të merrnin drejtësi pa pengesa, me cilësi nga një trupë gjyqësore profesionale dhe me integritet si dhe brenda afateve të arsyeshme.

Ri-organizimi i gjykatave dhe kompetencave të tyre tokësore i njohur ndryshe si harta e re gjyqësore, në parim mbart një rëndësi kyç për rritjen e aksesit, cilësisë dhe reduktimin e kostove për qytetarët në marrjen e drejtësisë, objektiva të rëndësishëm këto në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë. Ky proces duhet të kryhej në mënyrë transparente, duke u bazuar në vlerësimin e plotë të situatës dhe duke marrë në konsideratë objektivat, parimet dhe kriteret e përcaktuara në nenet 14 dhe 15, të një prej ligjeve organike më të rëndësishme të paketës së reformës në drejtësi, ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në dt. 06.10.2016. Në vlerësimin e KShH-së, këto parime e kriteret nuk u respektuan plotësisht, sikurse analizohet në vijimësi të këtij dokumenti.

Me urdhërin nr.78, dt.18.02.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka ngritur grupin ndër-institucional për vlerësimin dhe ri-organizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave, i përbërë nga anëtarë të KLGJ-së, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, përfaqësues të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, gjykatave administrative dhe Gjykatës së Lartë si dhe staf mbështetës i Këshillit¹. Afro tre vite e gjysmë më vonë, përkatësisht në dt.21.07.2022, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin nr.495, “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave gjyqësore të gjykatave”. Ky vendim, i bazuar në propozimin e Ministrit të Drejtësisë riorganizon gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, duke sjellë një ulje drastike të numrit të disa gjykatave në vend si vijon:

- a. Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm riorganizohen në 13 gjykata të rretheve gjyqësore, nga 22 gjykata të tilla, duke sjellë shkrirjen e 9 gjykatave.
- b. Gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm riorganizohen në një Gjykatë Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm, nga 6 gjykata apeli në nivel kombëtar, duke sjellë kështu shkrirjen e 5 gjykatave.
- c. Gjykatat administrative të shkallës së parë riorganizohen në 2 gjykata administrative të shkallës së parë me kompetenca tokësore, nga 6 gjykata të tilla, duke sjellë shkrirjen e 4 gjykatave.

Në total, me ri-organizimin e ri gjyqësor ose i njohur ndryshe si harta gjyqësore, shkrihen 18 gjykata, duke krijuar një situatë të jashtëzakonshme dhe të paprecedentë në këto 32 vite të demokracisë.

¹ <https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/06/relacion-harta-gjyqesore-F-1-Mbledhje-Plenare.pdf>, fq.1

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) ka qenë ndër organizatat e para që ka reaguar për efektet e riorganizimit të ri gjyqësor, menjëherë pasi është njohur lidhur me to me anë të medias. Në deklaratën e dt.14 Qershor 2021², KShH vuri një theks të veçantë tek nevoja për akses në drejtësi, pasi u njoh me raportimin që Kryetarja e KLGJ-së, kishte paraqitur në mbledhjen e Komisionit Parlamentar të Ligjeve, ku ndër të tjera flitej edhe për ri-organizimin e ri gjyqësor. KShH tërhoqi vëmendjen se përparësi në organizimin e ri të gjykatave duhet të kishte akses efektiv i qytetarëve, i cili përbën një objekt kyç të reformës në drejtësi. Kjo do të kërkonte studim të thelluar dhe të gjithanshëm si dhe konsultim të gjerë. KShH vuri në dukje se nevoja për konsultim rrjedh edhe në kuadër të ligjit “Mbi konsultimin publik”, pasi harta e re gjyqësore përbën një politikë me interes të lartë publik.

Në fillim të vitit 2022, KLGJ hodhi për konsultim draftin e vlerësimit paraprak për hartën e re gjyqësore. Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) tërhoqi vëmendjen, së bashku me 9 organizata të shoqërisë civile³, për:

- Mungesën e transparencës karshi publikut të veprimtarisë së GNP-së së ngritur nga KLGJ.
- Mungesën e një procesi konsultativ dhe gjithëpërfshirës përgjatë fazës së hartimit të raportit të vlerësimit nga ky grup pune.
- Mungesën e një studimi apo vlerësimi objektiv dhe të gjithanshëm, me avantazhet dhe disavantazhet e ri-organizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave të tyre tokësore.

Në këto kushte, u krijuan premisa për një propozim nga KLGJ dhe Ministria e Drejtësisë, për reduktimin drastik të numrit të gjykatave në vend. Shqetësimi më i madh është ai për funksionimin e vetëm 1 gjykate apeli të juridiksionit të zakonshëm, në rang kombëtar, ndërkohë që vende të tjera që kanë ri-organizuar gjykatat e tyre dhe janë referuar si model në vlerësimin e kryer nga KLGJ, kanë një ulje tepër të lehtë të gjykatave në nivel apeli. Vlen të përmenden Moldavia dhe Holanda, të cilat në reformat e ndërmarra për hartat gjyqësore, kanë ulur nga 5 në 4, numrin e gjykatave të apelit. Vlen të theksohet gjithashtu, se modele të hartëzimit të gjykatave edhe në vende të Bashkimit Evropian, sikurse është Portugalia, nuk mund të konsiderohen si të suksesshme sa kohë kanë evidentuar procese që qartazi kanë favorizuar ndarjen e gjykatave dhe shërbimeve të lidhura thjesht në bazë të përlllogaritjeve matematikore, pa marrë parasysh ngarkesën e çështjeve apo distancat e mëdha të zonave gjeografike.

Në dritën e parimit të shtetit të së drejtës, i pandashëm në sistemin e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka vlerësuar se “një gjykatë” duhet gjithmonë të “krijohet me ligj”, pasi përndryshe do t’i mungonte legjitimiteti i kërkuar në një

2 <https://ahc.org.al/njoftim-per-shtyp-aksesi-ne-drejttesi-prioriteti-me-madhori-hartes-se-re-gjyqesore/>

3 https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/02/Opinion-ligjor_Raporti-i-Vleresimit-per-Harten-e-re-Gjyqesore.pdf

shoqëri demokratike për të dëgjuar e shqyrtuar çështjet individuale. Në vlerësimin e KShH-së, procesi dhe kriteret e ndjekura nga KLGJ dhe Ministria e Drejtësisë për ri-organizimin gjyqësor, nuk janë në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse të ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor, duke vendosur në pikëpyetje standardet e parimit të gjykatës së krijuar me ligj.

Gjithashtu, aksesin në drejtësi dhe drejtësinë pa vonesa janë dy standarde tepër të rëndësishme të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor. Harta e re gjyqësore synon në mënyrë jo të ekuilibruar rritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe shpejtësinë e gjykimit, duke mos peshuar me kujdesin e duhur aksesin në drejtësi që kërkon ndër të tjerash edhe afërsinë e qytetarit me gjykatën. Por edhe në drejtim të efikasitetit gjyqësor, kjo hartë është bazuar në një vlerësim të projektuar të shqyrtimit të çështjeve në raport me numrin e gjyqtarëve që janë aktualisht në sistem, ndërkohë që vakancat, veçanërisht në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë afërsisht në masën 70%. Kjo gjykatë ka filluar të funksionojë në dt.1 Shkurt 2023, me 25 Gjyqtarë, ndërkohë që në organikën e saj ka 78 gjyqtarë⁴.

Vlen të nënvizohet se organika e numrit të gjyqtarëve mbi të cilën është konceptuar ky riorganizim është i 11 viteve më parë, sipas dekretit të Presidentit të Shqipërisë, duke datuar para reformës në drejtësi. Raporti i vlerësimit për propozimin e hartës së re nuk analizon varfërinë në vend (referuar papunësisë dhe të ardhurave që marrin shtetasit shqiptar) dhe njëkohësisht as cilësinë e rrugëve dhe transportit rrugor, mjetet e munguara të transportit në disa prej zonave të thella rurale dhe aksesin e grupeve të disavantazuara ekonomikisht në përdorimin e rrugëve dhe mjeteve të transportit.

Në funksion të analizës së realizuar në këtë dokument, KShH ka adresuar pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatave të Apelit në Republikën e Shqipërisë, pjesë e ri-organizimit gjyqësor territorial, një total prej 19 kërkesash për informacion sa i takon oponencës së brendshme të vetë gjykatave lidhur me organizimin e hartës së re gjyqësore. Vetëm 12 prej gjykatave i janë përgjigjur kërkesës tonë për informacion, ndërkohë që rezultoi se vetëm një gjyqtar në një Gjykatë Rrethi ka paraqitur shqetësimin e tij me shkrim drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, sipas të cilit shkrirja e gjykatave nuk respekton parimet bazë për përcaktimin e kompetencës tokësore që lidhen me afërsinë e individit me gjykatën, uljen e kostove të shërbimeve për qytetarin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve. Në vlerësim të KShH-së, heshtja apo mungesa e oponencës nga shumica dërrmuese e gjyqtarëve është tregues i interesit jo proporcional që ata kanë, për t'u transferuar drejt gjykatave më të mëdha apo për t'u promovuar në Gjykatën e Apelit në vijimësi.

Pavarësisht veprimtarisë shumë dinamike që KLGJ ka patur në drejtim të përgjigjes ndaj vakancave shqetësuese në sistem, masat e marra janë të natyrës së përkohshme dhe nuk i përgjigjen në plan afatgjatë nevojave të sistemit. Pamundësia e KLGJ për të parashikuar në mënyrë strategjike plotësimin e vakancave, veçanërisht në Gjykatat e Apelit si dhe për të projektuar uljen e stokut në masën prej afro 32,000 dosjesh për Gjykatën e vetme të Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm, krijon pasiguri ligjore dhe shqetësim të drejtë tek mijëra qytetarë dhe përdorues të gjykatave për çështjet e tyre që vijojnë të mbeten pezull në pritje për t'u gjykuar. Në këtë situatë, KLGJ i rekomandohet të shmangë komandimet e gjyqtarëve në pozicione pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë, pasi kjo do të përbente një menaxhim të gabuar të burimeve njerëzore në radhët e gjyqtarëve në kushtet e emergjencave me të cilat po përballet sistemi ynë gjyqësor⁵.

4 <https://shqiptarja.com/lajm/nga-sot-vetem-1-gjykatë-apeli-ne-tirane-shkrihen-5-te-tjera-ne-rrethe-32-mije-dosje-ne-pritje>

5 Shih psh vendimin: [VENDIM-Nr.538datë14.12.2022-PËR-KOMANDIMIN-E-Z.....-SI-DREJTOR-I-PËRGJITHSHËM-I-DREJTORISË-SË-PËRGJITHSHME-TË-ANTIKORRUPSIONIT-NË-MINISTRINË-E-DREJT-ËSISË.pdf \(klgj.al\)](#)



Sa i takon zbatimin të deritanishëm të hartës së re gjyqësore, KShH vëren se GNP e ripërtërirë nga KLGJ ka shfaqur gjithashtu mungesë transparence dhe aksesin të përfaqësuesve të shoqërisë civile në mbledhjet e tij, rrjedhimisht edhe mungesë të një procesi gjithëpërfshirës përgjatë fazës së akteve të nevojshme për konkretizimin e hartës së re gjyqësore. Vlerësojmë si tejet problematike, qasjen e treguar nga KLGJ për të mos operuar me marrjen e dokumentacionit zyrtar për shkëmbimin e të dhënave me gjykatat dhe institucionet e tjera të përfaqësuar në GNP për zbatimin e hartës së re gjyqësore. Mohimi i paarsyeshëm i aksesit në informacion për Planin e Veprimit dhe procesverbalet e GNP-ve ndaj një organizate monitoruese të sistemit të drejtësisë sikurse është KShH është gjithashtu shqetësues. I njëjti konstatim vlen edhe për mungesën e dokumentacionit dhe informacionit të konkretizuar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministria e Drejtësisë, të bashkë-ngarkuara për zbatimin e hartës gjyqësore, bashkërisht me KLGJ-në, sipas pikës 4 të VKM nr.495, dt.21.07.2022.

Sa i takon vijueshmërisë së personelit dhe administratës gjyqësore të gjykatave që propozohen të shkrihen, përkundëjt asaj që u parashikua në fazën e ideimit, që Harta e Re Gjyqësore nuk sjell pakësim të burimeve njerëzore, pavarësisht uljes së numrit të gjykatave, vihen re të dhëna kontradiktore në raport me strukturën organizatave të miratuar për secilën gjykatë⁶. KShH vëren se suprimohen një numër i konsiderueshëm pozicionesh në gjykatat e rretheve gjyqësore që do të shkrihen. Në funksion të transparencës karshi publikut, sa i takon efektet e hartës së re gjyqësore duke filluar nga gjykatat e apelit, KShH vlerëson se në faqen zyrtare të KLGJ-së duhet të pasqyroheshin të dhëna të përpunuara dhe të kategorizuara për numrin dhe pozicionet e punonjësve të transferuar në kuadër të ristrukturimit, ku janë transferuar, nëse kanë refuzuar transferimin cilat janë shkaqet si dhe ata ndaj të cilëve është vendosur përfundim i marrëdhënies së punës, dhe shkaqet që justifikojnë këto vendime.

KLJGJ rezulton se ka marrë disa vendime, në formën e akteve individuale, për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarëve për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku janë caktuar në mënyrë të përhershme. Në kuptim të kriterëve që kanë udhëhequr KLGJ-në për të propozuar për secilin magistrat që ka një pozicion të përhershëm në gjykatën që shkrihet, është e paqartë si janë përzgjedhur gjykatat e rretheve gjyqësore për të cilat bëhet propozimi për transferim të secilit prej tyre. Arsyeimi i vendimmarrjeve përbën gjithashtu një detyrim të parespektuar nga KLGJ sipas nenit 89, pika 2 e ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së drejtësisë”, sipas të cilit aktet administrative individuale të Këshillit, në lidhje me statusin e gjyqtarëve ose nëpunësve civilë gjyqësorë, bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, të shoqëruara me arsyetimin përkatës.

⁶ Referuar vendimit nr.555, dt.29.12.2022 të KLGJ dhe krahasimit të tij me raportin e vlerësimit të KLGJ-së për riorganizimin e ri gjyqësor.

1 Standardet Ndërkombëtare për Aksesin në Drejtësi

Kur flitet për standardet e aksesit në drejtësi, së pari prevalojnë standardet e parashikuara në aktet ndërkombëtare ku vendi ynë ka aderuar ose aspiron të aderojë, sikurse janë standardet e vendosura në traktatet dhe konventat e miratuara nga organizata ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara (OKB), BE, Këshilli i Evropës (KiE), Komisioni Evropian për Eficencën në Drejtësi (CEPEJ), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), standardet e vendosura nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GjDBE), etj.

Si pjesë e të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, e drejta për akses në drejtësi garantohet në një sërë aktesh ndërkombëtare. Kjo e drejtë garantohet ndër të tjerash në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut⁷ (1950), dhe në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (1966)⁸ të cilat janë ratifikuar nga vendi ynë.

Në nenin 6, paragrafi 1, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut parashikon: *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.”*

Një parashikim thuajse identik bën edhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, në nenin 14 të tij parashikohet: *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të trajtohet me paanësi dhe publikisht nga një gjykatë kompetente, e pavarur dhe e paanshme, e ngritur sipas ligjit, që do të vendosë qoftë për përcaktimin e çdo akuze të karakterit penal që drejtohet kundër tij, qoftë për konfliktet lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tij në fushën civile.”*

Sipas ligjit të Bashkimit Evropian, përkatësisht në nenin 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së thuhet se: *“Çdokush ka të drejtë për një dëgjuesë të drejtë dhe publike brenda një afati të arsyeshëm kohor, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar nga ligji. Çdo individ duhet të ketë mundësinë të këshillohet, të mbrohet dhe të përfaqësohet”*⁹. Neni 47 zbatohet për të gjitha të

7 https://www.echr.coe.int/documents/convention_sqi.pdf

8 <https://hrrp.eu/alb/docs/CCPR-a.pdf>

9 https://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text_en.pdf

drejtat dhe liritë që rrjedhin nga ligji i BE-së. Formulimi i kësaj dispozite është pothuajse i njëjtë me parashikimin e nenit 6 (1) të KEDNJ, me ndryshim se ky i fundit parashikon kufijtë e zbatimit të kësaj të drejte, sa i takon të drejtave dhe detyrimeve të natyrës civile si dhe akuzave penale në ngarkim të shtetasve. Rrjedhimisht, neni 47 garanton, në minimum, mbrojtjen e ofruar nga neni 6 i KEDNJ-së, në lidhje me të gjitha të drejtat dhe liritë që dalin nga e drejta e BE-së¹⁰.

Referuar standarteve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, neni 47 i Kartës së të Drejtave Themelore është interpretuar se mishëron parimin e BE-së që Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë mbrojtje gjyqësore efektive të të drejtave të një individi që rrjedhin nga legjislacioni i BE-së. U takon shteteve anëtare të BE-së të krijojnë një sistem të mjeteve juridike dhe procedurave që sigurojnë respektimin e të drejtave sipas ligjit të BE-së¹¹. Legjislacioni kombëtar nuk duhet të cenojë mbrojtjen efektive gjyqësore të këto të drejta.¹²

E drejta e aksesit në gjykatë është një e drejtë e nënkuptuar në të drejtën për një gjykim të drejtë sepse neni i sipërpërmendur i KEDNJ, sugjeron që mosmarrëveshjet gjykohen nga një gjykatë e pavarur dhe e krijuar me ligj. Referuar jurisprudencës së GJEDNJ, “E drejta për akses në gjykatë” nuk është absolute. Ajo mund t’i nënshtrohet kufizimeve, por këto nuk duhet të tkurrin ose zvogëlojnë aksesin që i është lënë individit në një mënyrë apo masë të tillë që vetë thelbi i së drejtës cenohet (Philis kundër Greqisë (nr. 1), § 59; De Geouffre de la Pradelle kundër Francës, § 28; Stanev kundër Bullgarisë [GC], § 229; Baka kundër Hungarisë [GC], § 120).

GJEDNJ vlerëson se, një kufizim nuk do të jetë në përputhje me nenin 6 § 1 të KEDNJ-së nëse nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet (Famullia Greke Katolike Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë [GC], § 89). E drejta e aksesit në gjykatë duhet të jetë “praktike dhe efektive” (Bellet kundër Francës, § 38). Por që kjo e drejtë të jetë efektive, një individ duhet “të ketë një mundësi të qartë dhe praktike për të kundërshtuar një akt që sjell ndërhyrje në të drejtat e tij” (§ 36; Nunes Dias kundër Portugalisë (vendim) në lidhje me parashikimet për njoftimin për t’u paraqitur).

Në rrethanat specifike të një çështje, GJEDNJ vëren se natyra praktike dhe efektive e së drejtës së aksesit në gjykatë mund të dëmtohet, ndër të tjerash nga kostoja e procedurave që pengon një individ t’i drejtohet gjykatës, në raport me gjendjen e tij financiare (Aït-Mouhoub kundër Francës, §§ 57-58; García Manibardo kundër Spanjës, §§ 38-45);

Megjithatë, aksesueshmëria në drejtësi apo në gjykatë përfshin disa aspekte të kësaj të drejte, siç është disponueshmëria e gjykatave me juridiksionin përkatës, disponueshmëria e interpretimit, aksesi në informacion dhe aksesueshmëria e vendimeve gjyqësore. Por mund të përfshijë edhe gjeografinë, që lidhet me largësinë e gjykatës; nëse vendndodhja e saj i pengon kërkuesit të marrin pjesë në mënyrë efektive në procesin gjyqësor¹³.

Komisioni European për Eficencën në Drejtësi¹⁴ (CEPEJ), ka publikuar në Dhjetor të 2014 një

10 [Vendim i GJED, C-619/10, Trade Agency Ltd v. Seramico Investments Ltd, 6 Shtator 2012, paragraf 52.](#)

11 [Vendimi i GJED., C-432/05, Unibet \(London\) Ltd and Unibet \(International\) Ltd v. Justitiekanslern, 13 Mars 2007, paragraf. 37-42](#)

12 [Vendimi i GJED, C-279/09, DEB Deutsche Energiehandels- und Beratungsgesellschaft mbH v. Bundesrepublik Deutschland, 22 Dhjetor 2010, paragraf 59](#)

13 https://www.echr.coe.int/documents/handbook_access_justice_eng.pdf shih faqen 25
<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:62013CJ0567&from=EN>

14 <https://www.coe.int/en/ëeb/cepej/about-cepej>

Udhëzues mbi Organizimin dhe Aksesueshmërinë e Ambienteve të Gjykatës¹⁵. Qëllimi i publikimit të këtij dokumenti nga Komisioni, ka qënë të sigurojë një kornizë referimi që mund të jetë e dobishme për administratorët dhe vendimmarrësit, gjatë ndërtimit të ambienteve të reja të gjykatave apo konvertimit të ndërtesave të vjetra¹⁶. Sipas Komisionit është mjaft e rëndësishme që në rastet kur ndërtohen ambiente të reja të gjykatave, të mbahen parasysh mundësitë e zhvillimit urban afatmesëm dhe afat-gjatë, me një vëmendje të veçantë tek mundësitë e transportit publik si dhe afërsia me zona të parkimit.¹⁷ Në rastet kur ndërtohen ambiente të reja për gjykatën, dhe është e nevojshme përzgjedhja e hapësirave të reja,¹⁸ duhet të konsiderohet që vendndodhja e gjykatës të ketë lidhje të mira me transportin publik, për të lehtësuar kështu aksesin në drejtësi, dhe në këtë rast në gjykatë, të qytetarëve.

Në vitin 2013, CEPEJ ka miratuar gjithashtu edhe një Udhëzues mbi krijimin e hartave gjyqësore, për të mbështetur aksesin në drejtësi, në një sistem gjyqësor cilësor.¹⁹ Objektivi i këtij dokumenti është të ofrojë një kornizë me anë të së cilës administratorët dhe politikëbërësit mund të ndërmarrin reforma dhe vendime për të hartuar (ose ndoshta ri-dizenuar) hartën gjyqësore të një vendi të tërë ose të një pjese të territorit të tij. Në pikën 2.3.4 të këtij Udhëzuesi, parashikohet “*Pozita gjeografike dhe transporti e infrastruktura e disponueshme*”, ku vihet theksi tek parimi që duhet të zbatohet për sa i përket pozitës gjeografike, duke minimizuar distancën midis institucionit gjyqësor dhe të gjitha bashkive në territorin e një vendi.

Referuar një studimi të Tetorit të vitit 2015, i kontraktuar nga UN Women²⁰ dhe i realizuar në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, nënvizohet se:

- Distanca e largët nga gjykata vlerësohet si pengesë kryesore për aksesin në drejtësi, e cila ndikon në mënyrë joproporcionale tek njerëzit e varfër dhe në nevojë, duke përfshirë gratë, si dhe banorët që jetojnë në zonat rurale dhe janë të varfër, duke mos patur akses në mjetet e transportit.
- Udhëtimi në distanca të mëdha gjeografike kërkon kohë dhe është i kushtueshëm, pasi mund të shkaktojë humbje të të ardhurave, si rezultat i kohës që personi duhet t’i dedikojë, duke u larguar nga puna për të udhëtuar në gjykata dhe për të marrë pjesë në procedurat gjyqësore.
- Masat që lehtësojnë aksesin, sa i përket distancës nga gjykatat, duhet të mbështeten si në të dhënat objektive/administrative ashtu edhe në të dhënat e perceptimit, pra si ndikon distanca tek perceptimi i njerëzve për aksesueshmërinë e sistemit të drejtësisë.

15 <https://rm.coe.int/16807482cb>

16 Shih pikën 2 të hyrjes së Udhëzuesit

17 Shih pikën 2.1.5 të Udhëzuesit

18 Shih pikën 4.1.1 të Udhëzuesit

19 <https://rm.coe.int/european-commission-for-the-efficiency-of-justice-cepej-revised-guidel/168078c492>

20 UN Women is the [United Nations](#) entity dedicated to gender equality and the empowerment of women.

2 Rekomandimet e Komisionit Evropian në kuadër të procesit të integrimit në BE, të vendit tonë

Sipas Raportit të Komisionit Evropian për vitin 2022²¹, Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar për funksionimin e gjyqësorit. Progresi ka qenë i kufizuar sa i takon rekomandimit për sistemin e menaxhimit të çështjeve dhe sistemin e trajnimit ligjor, i cili ka qenë i pezulluar për disa vite. Eficienca e sistemit gjyqësor është ndikuar negativisht nga tejzgjatja e procedurave, norma e ulët e evadimit të çështjeve dhe stoku i lartë i çështjeve gjyqësore.

Gjykatat me ngarkesën më të lartë janë Gjykata e Lartë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Administrativ. Kjo e fundit ka 18,415 çështje, nga të cilat 9938 janë çështje të vjetra për më shumë se dy vjet. Gjykata e Lartë ka stokun më të lartë të çështjeve, me më shumë se 35,822 çështje, ndër të cilat, 27,843 janë çështje më të vjetra se dy vite (ose 77% e tyre). Megjithatë, në vijim të emërimeve të reja në Gjykatën e Lartë, normat e evadimit janë rritur ndjeshëm, përkatësisht 117% të çështjeve penale dhe 193% të çështjeve administrative. Në mënyrë të veçantë, shqetësues është fakti se mesatarja për gjykimin e një çështje në apel është 893 ditë. Ndërkohë, në Gjykatën e Apelit Tiranë, kohëzgjatja e procedurave për një çështje penale është 5820 ditë ose afro 16 vjet.

Ndër rekomandimet e Komisionit Evropian të adresuara në vijimësi të raportit të tij për Shqipërinë, është nevoja për të konsoliduar përpjekjet për të forcuar efikasitetin dhe transparencën e të gjitha gjykatave dhe prokurorive. Në këtë drejtim, kërkohen ndër të tjerash, veprime të shpejta dhe të vendosura për të krijuar një sistem të integruar të menaxhimit të çështjeve, dhe paraqitja e një plani të ri zbatimi të qendrushëm për Hartën e re Gjyqësore.

21 https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en

3 Dritë hijet e procesit të vlerësimit të hartës së re gjyqësore në vendin tonë

3.1 Standartet për “Gjykatën e krijuar me ligj”

Sipas nenit 135, pika 1 të Kushtetutës (ndryshuar me ligjin nr.76/2016, neni 13), “Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj”.

Në dritën e parimit të shtetit të së drejtës, i pandashëm në sistemin e Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut, GJEDNJ ka vlerësuar se një “tribunal” ose “një gjykatë” duhet gjithmonë të “krijohet me ligj”, pasi përndryshe do t’i mungonte legjitimiteti i kërkuar në një shoqëri demokratike për të dëgjuar e shqyrtuar çështjet individuale (Lavents kundër Letonisë, § 81). Referuar kësaj jurisprudence, shprehja “e krijuar me ligj” përfshin jo vetëm bazën ligjore për vetë ekzistencën e një “gjykatë”, por edhe pajtueshmërinë e kësaj gjykatë me parashikimet ligjore të veçanta që e rregullojnë atë (Sokurenko dhe Strygun kundër Ukrainës, § 24). Ligjshmëria e një gjykatë ose tribunali duhet gjithashtu të përfshijë sipas këtij përkufizimi edhe përbërjen e tij (Buscarini kundër San Marino).

GJEDNJ ka vënë në dukje se edhe pse e drejta për një “tribunal të krijuar me ligj” është një e drejtë e pavarur sipas nenit 6 § 1 të KEDNJ, një ndërlidhje shumë e ngushtë është argumentuar në jurisprudence e kësaj gjykatë, midis kësaj të drejte specifike dhe garancive të “pavarësisë” dhe “paanshmërisë”. Kërkesat institucionale të nenit 6 § 1 ndajnë të njëjtin qëllim të zakonshëm të mbrojtjes së parimeve themelore të shtetit të së drejtës dhe ndarjes së pushteteve (çështja *Guðmundur Andri Ástráðsson*, §§ 231-233).

Sikurse do të analizohet në vijim të këtij seksioni, procesi dhe kriteret e ndjekura nga KLGJ dhe Ministria e Drejtësisë për r-iorganizimin e ri gjyqësor, nuk janë në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse, duke vendosur në pikëpyetje standartet e parimit të gjykatës së krijuar me ligj.

3.1.1 Transparenca dhe gjithëpërfshirja

Sipas nenit 13, pika 4 të ligjit nr.98/2016 për organizimin e pushtetit gjyqësor, procesi për caktimin ose caktimi rishitas i rretheve gjyqësore dhe i kompetencave tokësore të gjykatave kryhet në mënyrë



transparente, duke u bazuar në vlerësimin e plotë të situatës dhe duke marrë në konsideratë objektivat, parimet dhe kriteret e përcaktuara në nenet 14 dhe 15, të këtij ligji, dhe nevojën për vazhdimësi të shërbimeve gjyqësore, transferimin e personelit dhe organizimin e logjistikës. Por pavarësisht këtij parashikimi, KShH vëren se procesi i vlerësimit të ri-organizimit gjyqësor u realizua në kushtet e mungesës së transparencës ndërkohë që vlerësimi i situatës nuk ishte realist dhe i gjithëanshëm.

Teksa reforma në sistemin e drejtësisë, mundësoi reformim tërësor në përbërjen e Këshillave (KLGJ dhe KLP), me qëllim arritjen e ekuilibrave për të luftuar elementët korporatist të vërejtur nga organet e mëparshme, sa i takon karrierës dhe disiplinës së gjyqtarëve/prokurorëve, e njëjta qasje, mund të ishte reflektuar në përbërjen e GNP për hartën e re gjyqësore. Këto mbledhje nuk kanë qenë të hapura për publikun dhe për të interesuarit, përfshi këtu edhe organizatat e shoqërisë civile. Rrjedhimisht, përfaqësimi në këtë grup nuk garantoj mjaftueshëm larmishmëri dhe gjithëpërfshirje, ndërkohë që prezenca e gjyqtarëve nga gjykatat që propozohen të shkrihen pa mundësuar një proces përzgjedhës meritokratik në sytë e opinionit publik, është i diskutueshëm në sytë e një vëzhguesi publik, objektiv dhe të paanshëm.

Konsultimi në fazën fundore të draft raportit të vlerësimit të përgatitur nga grupi i punës në fillim të vitit 2022, i dha ngjyrimet formale këtij konsultimi. Gjithashtu, procesi i konsultimit me takime të dedikuara me qytetarët dhe njerëzit në nevojë, në mënyrë të veçantë përdoruesit e gjykatave, është një aspekt tjetër i munguar, por shumë i rëndësishëm, në metodologjinë e ndjekur nga grupi i punës. Ky konsultim mund të ishte shtrirë gjerësisht në aspektin gjeografik por edhe në kohë, veçanërisht për ato gjykata që propozohen të shkrihen.

Harta e re gjyqësore përbën, në vlerësimin e KShH, një proces me rëndësi jetike për qytetarët pasi aksesit në drejtësi është parakusht për të kërkuar rivendosjen e të drejtave në gjykatë, kur ato nuk respektohen apo shkelen. Edhe pse vlerësimi i nevojave të kësaj harte zgjati afro 3 vite, GNP i ngritur në KLGJ ka zhvilluar një numër të ulët mbledhjesh të vlerësuar proporcionalisht në këtë hark kohor, përkatësisht 10 mbledhje në total.

3.1.2 Kriteret e tjera Ligjore

Referuar nenit 15, pika 3 të ligjit nr.98/2016: “Rrëthet gjyqësore dhe kompetencat tokësore të gjykatave caktohen duke marrë parasysh, në mënyrë të njëjtë dhe të përshtatshme, kriteret e mëposhtme:

- ndarjen administrative territoriale të vendit, zhvillimin demografik, numrin e banorëve në raport me numrin e gjykatave, zhvillimin ekonomik, infrastrukturën rrugore dhe kushtet e transportit për në gjykata dhe midis gjykatave, si dhe karakteristikat gjeografike;
- ngarkesën në gjykata, në lidhje me çështjet e ardhura, të përfunduara dhe në shqyrtim, eficientësinë e gjykatave dhe gjyqtarëve në dhënien e drejtësisë, burimet njerëzore në dispozicion, vendndodhjen dhe përmasat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

KShH ka vlerësuar edhe më herët se parimet dhe kriteret ligjore të parashikuar në nenin 15 të ligjit nr.98/2016, për përcaktimin e kompetencave tokësore të gjykatave janë analizuar pjesërisht dhe në disa raste, në mënyrë të fragmentarizuar, jo realiste dhe jogjithëpërfshirëse. Në vijim të këtij seksioni, gjenden të analizuar në mënyrë konkrete disa prej këtyre parimeve dhe kriterëve.

a. Zhvillimi demografik

Me rëndësi të veçantë për ri-organizimin gjyqësor është vlerësimi i shpërndarjes dhe përqëndrimit të popullatës në njësitë administrative të secilës Bashki (kriteri demografik), në analizën e munguar për mënyrën e shpërndarjes së gjykatave në kuadër të këtij ri-organizimi.

Për ta ilustruar me një shembull, nisur nga të dhënat e publikuara nga INSTAT, më 1 Janar 2021 rezulton se Qarku i Gjirokastrës ka % më të ulët të popullsisë (rreth 2.1% të popullsisë së përgjithshme), ndjekur nga Qarku i Kukësit (2.6% të popullsisë së përgjithshme). Por nga analiza e realizuar nga Grupi i Punës është vërejtur se qendrat e këtyre qarqeve janë shndërruar në qendra të godinave të gjykatave pranë të cilave do të vendosen dhe gjykatat e shkrira.

b. Treguesi i “zhvillimit ekonomik” në raport me “infrastrukturën rrugore dhe kushtet e transportit për në gjykata dhe midis gjykatave”

Metodologjia e ndjekur për vlerësimin e kryer nga GNP për hartën e re gjyqësore krijon premisa serioze për cenimin e aksesit në drejtësi, të njerëzve që i përkasin grupeve në nevojë në vendin tonë, i cili përbën një nga 3 objektivat që parashikohen për caktimin e kompetencave tokësore, në nenin 14/gërma “a” e ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor. Aksesit në drejtësi sipas këtij parashikimi ligjor qartazi është i kushtëzuar me afërsinë e individit me gjykatën dhe renditet si parimi i parë në nevojat që shfaq organizimi i gjykatave.

KShH vëren se referuar raportit të Avokatit të Popullit për minimumin jetik në vendin tonë, të vitit 2020, përqindja e popullatës që është në rrezik varfërie ose jetoj me të ardhura shumë të ulëta është 49%. Referuar të dhënave të INSTAT, gjate vitit 2021, shkalla zyrtare e papunësisë për grupmoshën 15-74 vjeç është 11,5 %, ndërkohë që 32,7% e kontribuesve në kategorinë e të punësuarve me pagë merr një pagë mesatare mujore bruto deri në nivelin e pagës minimale zyrtare, 30,000 Lek të reja.

Sikurse është analizuar edhe në raporte të organizatave ndërkombëtare (cituar më sipër), distanca e largët nga gjykata vlerësohet si pengesë kryesore për aksesin në drejtësi, e cila ndikon në mënyrë joproporcionale tek njerëzit e varfër dhe në nevojë, duke përfshirë gratë, si dhe banorët që jetojnë në zonat rurale dhe janë të varfër, duke mos patur akses në mjetet e transportit.

Vlen gjithashtu të theksohet se pavarësisht se vendi ynë ka miratuar në Dhjetor të vitit 2017, ligjin Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”²², zbatimi i këtij ligji ka shfaqur vonesa dhe efekte të ngadalshme në drejtim të ofrimit të ndihmës juridike detyësore (që përfshin përfaqësimin në gjykatë) ndaj kategorive përfituese të tij. Ligji parashikon si kategori të veçanta përfituese viktimat e dhunës në familje, viktimat e abuzuar seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, viktimat e mitur dhe të miturit në konflikt me ligjin, fëmijët të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore, personat që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, personat të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale, etj. Gjithashtu, të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e ka çdokush që provon se ka të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet për këshillim, përfaqësim dhe/ose mbrojtje në çështjet penale, në çështjet administrative dhe në çështjet civile. Të ardhurat e një personi, i cili jeton në një familje konsiderohen të pamjaftueshme, nëse të ardhurat në total të të gjithë pjesëtarëve të familjes, të pjesëtuara me numrin e anëtarëve të familjes, janë më të ulëta se 50% e pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi. Sipas VKM-së nr.158, dt.12.03.2022, duke filluar nga Prilli i vitit 2022, paga bazë minimale mujore, në shkallë

22 <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/LIGJ-nr.-111-2017-date-14.12.2017.pdf>

vendi për punonjësit, e detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo person juridik apo fizik, vendas apo i huaj, është 32,000 Lek²³. E zbatuar në kontekstin e ligjit për ndihmën juridike falas të garantuar nga shteti, nëse një familje që jeton në qytetin e Kukësit apo të Gjirokastrës, ka një çështje të natyrës pronësore, në fushën e marrëdhënieve të punës, etj, në pritje për t'u gjykuar në gjykatë apeli, por të ardhurat mesatare për individ në muaj janë 17,000 Lek, ajo nuk mund të përfitojë nga ndihma juridike falas e garantuar nga shteti.

Pra përfitimi i ndihmës juridike falas të garantuar nga shteti është për fashën më të varfër të popullsisë, ndërkohë referuar të dhënave të INSTAT, ka shumë familje në pamundësi ekonomike të cilët edhe pse nuk janë pjesë e kësaj fashe, nuk janë në gjendje të paguajnë kostot e shtuara që do të vijnë si rezultat i kostove të transportit dhe kohës që ju duhet avokatëve dhe palëve për të lëvizuar nga vendbanimi i tyre drejt gjykatave të ri-organizuar. Gjithashtu vlen të theksohet se sipas raportit të vlerësimit të CEPEJ për sistemet gjyqësore në Evropë, buxheti i akorduar nga shteti shqiptar për ndihmën juridike falas edhe pse ka shënuar rritje, sërish numri i çështjeve për të cilat është dhënë ndihmë ligjore falas për 100,000 banorë, mbetet konsiderueshëm nën mesataren e vendeve anëtare të Këshillit të Evropës²⁴.

Raporti i vlerësimit të KLGJ nuk analizon varfërinë në vend (referuar papunësisë dhe të ardhurave që marrin shtetasit shqiptar) dhe njëkohësisht as cilësinë e rrugëve dhe transportit rrugor, mjetet e munguara të transportit në disa prej zonave të thella rurale dhe aksesit të grupeve të disavantazuara ekonomikisht në përdorimin e rrugëve dhe mjeteve të transportit. Në seancën dëgjimore të zhvilluar në Komisionin e Ligjeve²⁵ me përfaqësues të KLGJ-së, Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrin të Drejtësisë, Avokatit të Popullit, Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe KShH-së, rezulton se GNP-së i ka munguar ky informacion nga Ministria përgjegjëse në fushën e transporteve. Kjo situatë është tejet problematike, duke sjellë mosrespektimin e këtij kriteri të rëndësishëm ligjor për riorganizimin e gjykatave në vendin tonë, e rrjedhimisht duke krijuar pengesa serioze në drejtim të aksesit të qytetarëve në gjykatë.

GNP ka konkluduar se koha që i nevojitet një banori të një njësie administrative drejt gjykatës kompetente të rrethit gjyqësor, deri në dy orë, ose pak më shumë, mund të jetë e pranueshme. GNP pranon se nuk ka një standart të pranueshëm ndërkombëtarisht, ndërkohë që në raportin e mëparshëm, i është referuar kësaj kohëzgjatje si e arsyeshme, bazuar në një analizë të kryer në Britani, shtet ky me standart jetese dhe transport publik më të zhvilluar, në raport me vendin tonë. Por kjo e dhënë nuk është e analizuar në mënyrë realiste dhe objektive.

Sistemi Google Maps, mbi të cilin GNP ka llogaritur distancat drejt gjykatave që do të përthithin gjykatat e shkrija, nuk reflekton infrastrukturën e rrugëve dhe as kushtet e transportit drejt këtyre gjykatave. Megjithatë, edhe nëse do të merrnim të mirëqenë të dhënat e këtij sistemi, sërish distancat janë të konsiderueshme. Kështu, sa i përket shkrirjes së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Krujë, vlerësojmë se nuk është mbajtur në konsideratë numri i shtetasve të privuar nga liria që vuajnë dënimin pranë IEVP Fushë Krujë. Duke u bazuar në sistem përlllogaritës të distancës (Google Maps) rezulton se një shtetasi që vuan dënimin pranë IEVP Fushë - Krujë i duhet të udhëtojë dyfishin e distancës kilometrike pasi Gjykata e Krujës shkrihet me Gjykatën e Durrësit (për çështjet që janë në kompetencë të saj). Nëse marrim propozimin e shkrirjes së Gjykatës së Lushnjes me atë të Fierit dhe përlllogarisim kohën që i duhet një banori të Ballagatit të Lushnjes, deri në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, do të shohim se platforma Google Maps, llogarit kohën që i duhet për të

23 <https://www.tatime.gov.al/d/8/45/0/1707/njoftim-per-pagen-minimale-nga-periudha-prill-2022>

24 <https://rm.coe.int/cepej-fiche-pays-2020-22-e-web/1680a86276>

25 <http://www.parlament.al/lajme/%203fb7a03f-b367-45fb-bf80-41c798f8e2c7>

lëvizur me makinë, por jo me mjetet e transportit publik. E njëjta pamundësi llogaritur, vërehet edhe midis dy gjykatave, asaj të Lushnjës dhe Fierit. Koha e udhëtimit dhe vështirësitë për të udhëtuar nga një rreth gjyqësor në tjetrin, vështirësohen për distanca më të mëdha. Distanca kohore e llogaritur nga Google Maps, midis Gjykatës së Tropojës dhe asaj të Kukësit (që propozohen të shkrihen me qendër Kukësin) reflekton kohëzgjatjen 2 h e 17 min me automjet, ndërkohë mungon informacioni për mjetet e transportit publik. Nëse do të llogarisim kohën që i duhet një banori të zonës së Ceremit në Tropojë, për të shkuar në Gjykatën e Kukësit, i duhen ekzaktësisht 3 orë e 6 minuta, me automjet privat, ndërkohë që gjendja ekonomike për banorë të kësaj zone ose zonave të skajshme të Bashkisë Tropojë vështirëson apo pamundëson aksesin në drejtësi.

I njëjti shqetësim vërehet edhe për kohën maksimale të përlllogaritur për të mbërritur pranë Gjykatës Kombëtare të Apelit të Juridiksionit të përgjithshëm, veçanërisht për banorët e skajeve më të largëta që jetojnë pranë zonave kufitare në pjesën jugore, juglindore, veriore dhe veri lindore/perëndimore të vendit tonë.

c. Numri i gjyqtarëve

Referuar tabelës për shkrirjen e 9 Gjykatave të Rrethit Gjyqësor, GNP cilëson se ato nuk kanë në organikë, numrin minimal të mjaftueshëm të gjyqtarëve që të garantojnë rritjen e efijencës dhe specializimin. Në kuptim të organikës së gjykatave, Grupi i punës ka marrë si referencë atë të përcaktuar me Dekretin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë të 10 viteve më parë, përkatësisht të Nëntorit të vitit 2012.

Por në fakt, me legjislacionin e ri të drejtësisë, të miratuar para 6 viteve, përcaktimi i numrit të gjyqtarëve është kompetencë ekskluzive e Këshillit të Lartë Gjyqësor²⁶, i cili vlerëson numrin e gjyqtarëve për çdo gjykatë, të paktën çdo 5 vjet. Në këtë proces, Këshilli duhet të mbështetet në të njëjtat objektiva të parashikuar për caktimin e kompetencave tokësore gjykatave sipas nenit 14 të ligjit për pushtetin gjyqësor si dhe në të njëjtat kritere, të ri-organizimit gjyqësor sipas nenit 15, pika 3, gërma “b, të lidhura specifikuist, me ngarkesën në gjykata, efijencën, burimet njerëzore në dispozicion, etj.

E thënë ndryshe, ri-organizimi gjyqësor dhe caktimi i numrit të gjyqtarëve, duhej të ishin dy procese të realizuara në kohezion të plotë dhe paralelisht. Ri-organizimi gjyqësor nuk duhej të kushtëzohet nga një organikë e vjetër e 10 viteve më parë, që nuk i përgjigjet nevojave për drejtësi të qytetarëve që banojnë në zonat ku gjykatat propozohen të shkrihen.

Vlen të theksohet gjithashtu se për vitin 2020, CEPEJ ka konstatuar se numri i gjyqtarëve për 100,000 banorë është 10,8, ndjeshëm më ulët se mesatarja e vendeve të KiE-së²⁷. Ky numër ka pësuar sërish ulje, pasi vakancat në sistem janë rritur si rezultat edhe i procesit të vettingut. Përgjatë gjithë periudhës pas dhjetorit të vitit 2018 që përkoji me ngritjen e Këshillave, KShH ka bërë thirrje për vlerësimin e kujdesshëm të nevojave imediate se si mund të plotësohen vakancat, për të kaluar më pas, gradualisht dhe paralelisht në specializimin e gjyqtarëve dhe trupave gjykues dhe krijimin e seksioneve me jo më pak se 6 gjyqtarë.

26 Neni 22, pikat 3 dhe 4 - Procesi i përcaktimit të numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë mbështetet në objektivat e parashikuar në nenin 14, të këtij ligji, me qëllim sigurimin e ngarkesës së ekuilibruar të punës së gjithë gjyqtarëve në Shqipëri. Procesi kryhet në mënyrë transparente, duke u bazuar në analizën e raporteve vjetore dhe efijencës së masave të marra për zbatimin e rekomandimeve të përcaktuara në raportet vjetore, sipas pikës 2 të këtij neni.

27 <https://rm.coe.int/cepej-fiche-pays-2020-22-e-web/1680a86276>



d. Efiçienca

Raporti i CEPEJ i vitit 2022 (me të dhëna që i përkasin 2020), vëren se koha në dispozicion për gjykimin e çështjeve civile dhe tregtare në shkallë të dytë është 1742 ditë ose 4.7 vjet dhe për çështjet administrative është 4485 ditë ose 12.2 vjet. Ky tregues është ekstremisht i lartë.

Kohëzgjatja e çështjeve sipas kategorive të tyre është një tregues i rëndësishëm për të vlerësuar efiçencën e gjykatave të ri-organizuar dhe është i lidhur drejtpërsëdrejti me gjykimin brenda afateve të arsyeshme të çështjeve, si një nga standardet e së drejtës për proces të rregullt gjyqësor. Por kjo e dhënë ka munguar dhe GNP ka referuar pamundësinë për të marrë në konsideratë këtë tregues dhe analizimin e stokut. Për një proces vlerësimi që zgjati afro 3 vjet, kjo mund të ishte adresuar qoftë dhe pjesërisht, nëse do të pilotohej pjesërisht bazuar në të dhënat që ofron sistemi i menaxhimit ICMS, në ato gjykata ku është i aplikueshëm. Gjithashtu, në vlerësimin e KSHH-së shtimi i personelit të nevojshëm administrativ për mbledhjen dhe përpunimin manual të të dhënave në ato gjykata që nuk ofrojnë sistemin e duhur të menaxhimit dhe përpunimit elektronik, mund të vlerësohej si një opsion i zbatueshëm në fazën e hershme të ideimit të hartës së re gjyqësore.

Vendosja apo ruajtja e një ekuilibri, midis shpërndarjes së ngarkesës së punës dhe shpërndarjes së gjyqtarëve ndërmjet gjykatave, sipas GNP-së është tregues i mungesës së efikasitetit të sistemit çka duhet të korrigjohet me hartën e re. Megjithatë, vërehet se një pjesë e gjykatave që propozohen të shkrihen, dhe me organikën e gjyqtarëve kanë ngarkesë më të lartë se mesatarja prej 429 çështjesh në vit (Kavaja 591, Kurbin 671, Kruja që ka në juridiksion edhe IEVP Krujë, ka një ngarkesë 593, dhe Lushnja 490). I njëjti shqetësim vërehet edhe lidhur me ngarkesën e gjyqtarëve në Gjykatat e Apelit. Është e vërtetë që lista në kuptim të ngarkesës kryesohej nga Gjykata e Apelit të Tiranës, me 20,350 çështje në total ose 2572.7 çështje për gjyqtar. Edhe pse jo në këto shifra, disa prej gjykatave të Apelit në vend serish kishin një ngarkesë të konsiderueshme, përkatësisht Durrësi me 999.6 çështje për gjyqtar, Shkodra me 853.8 çështje për gjyqtar, Vlora me 1040.3 çështje për gjyqtarë. Pra edhe në këto Gjykata, përdoruesit e tyre po përballeshin me vonesa në gjykimin e çështjeve (p.sh. referuar të dhënave të Komisionit Evropian për Gjykatën e Shkodrës). Rrjedhimisht, përqendrimi i të gjithave çështjeve në të njëjtën Gjykatë të vetme të Apelit me juridiksion të përgjithshëm, teksa lehtëson përdoruesit e ish Gjykatës së Apelit Tiranë, vështirëson më tej në kuptim të kohëzgjatjes dhe nevojës për të marrë drejtësi pa vonesa, përdoruesit e Gjykatave të Apelit Shkodër, Vlorë apo Durrës. Vlen të theksohet se barazia në ligj dhe para ligjit, nuk nënkupton barazi të situatave të paligjshmërisë, sikurse është cenimi i standardit të gjykimin brenda një kohe të arsyeshme dhe drejtësisë pa vonesa. Gjithashtu, kjo hartë e re gjyqësore nuk i jep asnjë përdoruesi dhe as publikut në tërësi, informacion se cila është kohëzgjatja mesatare e gjykimin të një çështje të caktuar (të kategorizuar e nën-kategorizuar në sferën e çështjeve civile, penale dhe administrative).

Zgjidhja e ofruar për të shkrirë disa gjykata, duke bërë të mundur specializimin e gjyqtarëve dhe uljen e kohëzgjatjes së proceseve, teksa mund të kontribuojë pozitivisht në drejtim të uljes së kohëzgjatjes, nga ana tjetër, në mënyrë të disbalancuar krijon probleme të aksesit në drejtësi.

Me qëllim marrjen e shërbimeve administrative gjyqësore sa më pranë vendbanimit të qytetarit, GNP ka propozuar ngritjen e zyrës së shërbimit gjyqësor. Megjithatë, kjo zgjidhje, teksa do të lehtësonte qytetarin në dorëzimin e dokumentacionit procedural të çështjeve gjyqësore të iniciuara apo në proces, nuk i jep zgjidhje të plotë aksesit efektiv në organet e drejtësisë, sa i takon nevojës së prezencës së palës apo avokatëve mbrojtës, në seancat gjyqësore. Aksesit në drejtësi, nëse nuk garantohet njëkohësisht e drejta e palëve për tu dëgjuar drejtësisht dhe publikisht para gjykatës. Por nëse shumë qytetarë, do të kenë vështirësi për t'ju qasur gjykatës përgjatë proceseve të tyre gjyqësore, si rezultat i pamundësisë

ekonomike, atëherë aksesit në drejtësi do të cenohet, duke i privuar këta shtetas nga e drejta për një proces të rregullt.

Në raportin e vlerësimit të hartës, grupi i punës referon se debati kontradiktor në gjykimin në apel për gjithçka do të mund të shqyrtohet në dhomë këshillimi apo në seancë gjyqësore, nuk kërkon praninë e palëve në seancë siç ndodh zakonisht me gjykimet në shkallë të parë. Sipas vlerësimit, në pjesën më të madhe të rasteve, gjykimi në apel përfundon si rregull me një seancë, pasi kërkon një përfaqësim më të specializuar (me avokat), duke mos e bërë të domosdoshme praninë e vetë palës. KShH vlerëson se këto argumente nuk janë realist dhe nuk i përgjigjen të drejtës për mbrojtje efektive. Përveç se është e nevojshme ofrimi i statistikave për këtë indikator, duhet theksuar se është në diskrecion të vetë palëve ndërgjyqëse të vlerësojnë nëse dëshirojnë të jenë prezent në seancë, pavarësisht nëse kanë ose jo një mbrojtës. Gjithashtu, edhe avokatët duhet të përshkojnë një distancë të caktuar nga bashkita ku ata punojnë drejt Gjykatës Kombëtare të Apelit dhe sa më e gjatë të jetë kjo distancë, aq më shumë rëndon në kostot e avokatit që në shumë raste përballohen dhe paguhen nga qytetarët.

GNP ka identifikuar si model pozitiv për krijimin e një gjykate të vetme të Apelit Administrativ dhe atë të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Por në këtë rast, vlerësojmë se kriteret përcaktuese nuk mund të analizohen në mënyrë të njëjtë, për shkak të kompetencës lëndore dhe rrjedhimisht natyrës së çështjeve që gjykon secila prej këtyre Gjykatave. Ndryshimi midis tre gjykatave të apelit (juridiksioni i përgjithshëm, administrativ dhe ai i posaçëm për veprat penale në fushën e korrupsionit dhe krimit të organizuar) duhet parë jo vetëm në aspektin e thjeshtë statistikor për numrin e çështjeve përgjatë një viti dhe stokun, por edhe në drejtim të statusit ekonomiko-social të palëve ndërgjyqëse dhe të pandehurve. Kështu, nga monitorimi i organizatave, të çështjeve penale në fushën e korrupsionit rezulton se të pandehurit kanë mundësi më të mira ekonomike të përfaqësohen me avokat privat. E njëjta logjikë vlen edhe për të pandehurit e akuzuar për vepra penale në fushën e krimit të organizuar.

e. Vendndodhja dhe përmasat e IEVP-ve

Sa i përket shkrirjes së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Juridiksionit të Përgjithshëm Krujë, KShH ka vërejtur se në analizën e realizuar nuk është mbajtur në konsideratë numri i shtetasve të privuar nga liria që vuajnë dënimin pranë IEVP Fushë Krujë. Pranë IEVP Fushë – Krujë, shtetasit e privuar nga liria janë në ndjekje të proceseve të tyre, veçanërisht shtetasit e paraburgosur. Shkrirja e kësaj gjykate mund të krijonte problematika në drejtim të aksesit të këtyre shtetasve. Kjo, duke mbajtur në konsideratë dhe mjetet e kufizuara logjistike e burimet njerëzore që administrata e sistemit të burgjeve ka për shoqërimin e shtetasve të privuar nga liria në proceset gjyqësore. Në këtë drejtim, vlen të nënvizohet gjithashtu, Rekomandimi nr. 2.3.10 i Udhëzuesit të CEPEJ për krijimin e hartave gjyqësore, sipas të cilit vlerësohet si kriter influencues reduktimi i distancave të udhëtimit për të pandehurit e burgosur të përfshirë në një proces gjyqësor, për arsye ekonomike dhe sigurie. Gjithashtu, vërehet se në analizën e realizuar nuk ka referenca statistikore për një periudhë të caktuar, për vendbanimin e palëve ndërgjyqëse të çështjeve të gjykuara nga Gjykata e Krujës, çka do të shërbente një vlerësimi më realist sa i takon aksesit të tyre pranë Gjykatës në distancën më të afërt.

Gjithashtu, KShH vëren se propozimi për shkrirjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, nuk ka patur në konsideratë numrin e shtetasve të privuar nga liria të akomoduar në IEVP Kosovë (Lushnje) dhe si ndikon ky ri-organizimi në ndjekjen e çështjeve të tyre të cilat janë duke u gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje.

4 Hartat Gjyqësore të vendeve të tjera (Modeli i Portugalisë)

Në Shtojcën B) të raportit të vlerësimit, GNP ka analizuar vendet fqinje si Bosnje-Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Kroacia, të cilat në fakt edhe pse me një popullsi gati të përafërt me vendin tonë, kanë një numër më të lartë gjykatash apeli, në raport me propozimin për një gjykatë të vetme apeli me juridiksion të përgjithshëm, në rastin e Shqipërisë. Gjithashtu, tërheq vëmendjen fakti se shtete të tjera si Moldavia dhe Holanda kanë ulur lehtë numrin e gjykatave të apelit, përkatësisht nga 5 në 4 gjykata apeli, ndërkohë që në mënyrë krahasimore vihet re që propozimi për 1 nga 6 gjykata apeli të juridiksionit të përgjithshëm është drastik.

Vende si Danimarka apo Finlanda kanë një numër më të ulët gjykatash, duke garantuar mbulimin e një numri më të lartë banorësh si dhe sipërfaqeje. Për të konkluduar në një analizë të mirëfilltë krahasimore ndërmjet sistemeve të organizimit gjyqësor, do të ishte e nevojshme që GNP të bazohej edhe në analizën e zhvillimit ekonomik të këtyre vendeve. Në dallim nga vendin ynë, për shkak të nivelit të lartë të jetesës, shtete si Danimarka, Finlanda apo Suedia kanë mundësinë të garantojnë qytetarëve shërbim të aksesit në drejtësi, edhe me një numër më të reduktuar gjykatash. Ky aspekt duhet analizuar edhe në raport me legjislacionin procedural të këtyre shteteve, hapësirave të përdorimit të teknologjisë së informacionit nga qytetarët dhe nga gjykatat, etj.

Duke parë situatën që vendi po kalon në drejtim të zbatimit të reformës në drejtësi dhe vakancave që janë krijuar në sistemin gjyqësor, si dhe faktin që në këto shtete nuk ka patur ulje drastike të numrit të gjykatave, krahasimet e realizuara nga GNP nuk kanë mundur të identifikimin e një modeli optimal të riorganizimit gjyqësor, të përshtatshëm për vendin tonë. Në mënyrë të veçantë, tek ky model duhet të prevalojë edhe zhvillimi ekonomik i vendit dhe mundësitë financiare të atyre shtetasve që nuk përfitojnë nga ndihma juridike falas, por serish janë në kushtet e pamundësisë për të përballuar shpenzimet si rezultat i shkrirjes së një numri të konsiderueshëm gjykatash.

4.1 Vështrim në Modelin e Hartës Gjyqësore në Portugali

Si rast studimor për të vlerësuar impaktin që ka patur ulja e numrit të gjykatave, ndër vendet e referuara në raportin e vlerësimit të GNP për hartën e re gjyqësore, është marrë Portugalia, shtet anëtar i Bashkimit Evropian.

Që në fillimin e vitit 2000 ka pasur diskutime lidhur me reformimin e sistemit gjyqësor të Portugalisë. Në vazhden e këtyre diskutimeve, me ligjin Nr. 52/2008, u miratua nga Parlamenti Portugez, reforma e hartës së re gjyqësore e cila synonte të riorganizimin dhe funksionimin e gjykatave, me qëllim bashkimin e 308 gjykatave në 20 gjykata të mëdha që funksionojnë me seksione të ndryshme në të njëjtin rreth.²⁸ Miratimi i këtij ligji nuk ishte konsultuar paraprakisht nga publiku, duke i dhënë fuqi të menjëhershme ligjore por me rezervën që kjo reforme të jetësohej fillimisht pas zbatimit të një projekti pilot. Sipas këtij projekti, reforma do të kalonte më parë në një fazë eksperimentale dhe që do të përfshinte vetëm 3 rajone (Alentejo Litoral, Baixo Vouga dhe Grande Lisboa-Noroeste)²⁹. Me vendimi të Ministres së Drejtësisë së asaj kohe u vendos që që përveç testimit të kësaj reforme të mundësohej edhe reforma e ligjit procedural në mënyrë që kjo e fundit dhe reformimi gjyqësor të konvergonin së bashku. Në përfundim të kësaj faze eksperimentale synohej të arrihej një fazë e vërtetë konsultimi dhe reflektimi me institucionet dhe stafet e përfshira për të përfutuar nga përvoja e tyre dhe për të marrë një vizion më të gjerë dhe inovativ për reformën, por edhe për të siguruar që reforma të kuptohet dhe të mbështetet nga njerëzit që do të ishin përgjegjës për të.³⁰

Në ri-organizimin e sistemit gjyqësor janë mbajtur në konsideratë disa kritere të cilat konsistojnë si më poshtë:

- a. Numri i çështjeve;** gjykatat që trajtojnë më pak se 250 çështje në vit do të mbyllen, ndërkohë që në rastin e Shqipërisë janë mbyllur gjykata të cilat vetëm ngarkesën mesatare të çështjeve për gjyqtarë e kanë patur mbi 400 çështje në vit;
- b. Kriteret e distancës:** nëse një gjykatë që merret me pak çështje ndodhet më pak se një orë larg nga një gjykatë tjetër që mund të trajtojë çështjen, ajo duhet të mbyllet. Ndërkohë që në rastin e Shqipërisë, sikurse është analizuar më herët, distancat midis gjykatave (ta shkruara dhe atyre që i përthithin janë në disa raste të konsiderueshme, veçanërisht për Gjykatat e Apelit dhe ato administrative të shkallës së parë.
- c. Cilësia e pajisjeve të gjykatave dhe prona e godinës së gjykatës:** nëse është marrë me qira dhe pajisjet janë të vjetra, duhet të mbyllen, por nëse është e Ministrisë së Drejtësisë dhe është në gjendje të mirë, duhet të mbetet. Ky element dhe investimet që janë bërë në infrastrukturën e një pjese të gjykatave të shkruara nuk janë vlerësuar në rastin e hartës gjyqësore në vendin tonë.
- d. Tendencat demografike:** nëse regjistrimi i vitit 2011 tregon se një zonë gjeografike është braktisur, gjykatat e saj duhet të mbyllen.

Zvogëlimi i numrit të gjykatave nga ana e qeverisë nuk kishte si qëllim që ky proces të rrisë distancën mes drejtësisë dhe qytetarëve, veçanërisht për ata që jetojnë në fshatra larg qyteteve kryesore. Për këtë qëllim, është planifikuar të krijohen seksione afërsie që funksionojnë në ndërtesat ku gjykatat ishin instaluar më parë me pajisje që mundësojnë akses të plotë në sistemin kompjuterik në të gjitha pjesët e rajonit.

28 Harta ekzistuese më parë ishte rezultat i një evolucioni me rrënjë të thella në shekullin e 19-të. Ai bazohej në juridiksione shumë të vogla territoriale, të quajtura komarka, dhe gjykata të shumta të vogla të shpërndara në të gjithë vendin, të cilat nuk favorizonin specializimin dhe efikasitetin e sistemit gjyqësor. Për më tepër, në shumë raste, komarkat nuk ishin në përputhje me fushat e juridiksionit të administratës vendore, sigurinë publike, sigurimet shoqërore dhe institucionet e mbledhjes së taksave, duke kontribuar kështu në përkeqësimin e problemeve të efikasitetit të sistemit gjyqësor.

29 https://www.researchgate.net/publication/326686070_Judicial_Reforms_%27Under_Pressure%27_The_New_MapOrganisation_of_the_Portuguese_Judicial_System

30 <https://rm.coe.int/comparative-study-of-the-reforms-of-the-judicial-maps-in-europe/168078c53a>

Përveç, arsyeve të cituara më sipër, kjo reformë shënonte një moment historik pasi në vitin 2011 është nënshkruar me Trojkën (Bashkimi Europian, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Qendrore Europiane), Memorandumi i Mirëkuptimit, sipas të cilit Portugalia vendosej në pozitën e një shteti të detyruar për të ndërmarrë reforma të mëdha që synojnë kryesisht uljen e shpenzimeve shtetërore në të gjitha fushat.³¹ Ky moment shënon edhe përfundimin e testit pilot të zbatuar në 3 rajonet Portugeze. Megjithatë nga reformat e shumta në sistemin e drejtësisë, u konstatuan disa vështirësi, duke i bërë përmirësimet në sektorin e drejtësisë një proces të gjatë dhe jo konsistent. Ndër arsyet e shumta për këtë, duhet të theksohen gjashtë faktorët e mëposhtëm, të cilët kanë mbetur relativisht të qëndrueshëm në dekadat e fundit:

- a. mungesa e planifikimit të përgjithshëm dhe të bazuar siç duhet (nuk ka studime dhe/ose përdorim të mirëfilltë të studimeve);
- b. mungesa e burimeve njerëzore, teknike dhe financiare (përfshirë ato të nevojshme për zbatimin e reformave të përshkruara);
- c. mbështetje e papërfillshme (ose, në disa raste, e tepruar) nga anëtarët e gjyqësorit dhe specialistë të tjerë për identifikimin e problematikave, përcaktimin dhe vlerësimin e reformave;
- d. investime të ulëta në trajnime, veçanërisht trajnime të vazhdueshme për gjyqtarët;
- e. tranzicionet që ishin shumë të shpejta, për shkak të presionit të Trojkës duke përdorur reforma sporadike për të trajtuar problemet strukturore;
- f. përdorimi i kufizuar i skemave pilot për të testuar dhe vlerësuar zgjidhjet dhe rindërtimin e strategjive përpara investimeve më të mëdha.³²

Në sajë të Memorandumit të Mirëkuptimit, me qëllim për të mos humbur mbështetjen financiare në krizën ekonomike të cilën po kalonte vendi, Ministria e Drejtësisë ndërmorri nismën për një Hartë të re Gjyqësore, 5 vite më vonë. Me anë të ligjit 62/2013 të organizimit të sistemit gjyqësor u ul numri i gjykatave të shkallës së parë nga 311 deri në njëzet e tre gjykata kryesore (të përbëra nga 218 seksione qendrore dhe 290 seksione vendore që zëvendësojnë ish-gjykatat). Në reformën e nisur u ndoqën tre synime kryesore: zgjerimi i zonës që mbulon çdo gjykatë kryesore, specializimi i gjyqtarëve sipas fushave ligjore dhe prezantimi i një modeli të ri të menaxhimit të gjykatave.

Kjo reformë në drejtësi kritikohet se shpërfilli të gjitha përvojat dhe rezultatet e mëparshme të projektit pilot, si dhe kundërshtimet e përfaqësuesve vendorë dhe në radhët e politikës, argumentet e profesionistëve ligjor dhe paralajmërimet e ekspertëve. Ajo u planifikua dhe u zbatua në një periudhë jashtëzakonisht të shkurtër kohore (dy vjet). Duke pasur parasysh kompleksitetin dhe hapat e nevojshëm për zbatimin e saj (përshtatja e ndërtesave, rrjeteve kompjuterike, trajnimi profesional, ndryshimet në legjislacion dhe softuer, ndër të tjera), vendimi politik për këtë ri-organizim në një kohë kaq të shkurtër ishte i papritur. Objektivi ishte i qartë: gjithçka duhej bërë përpara skadimit të (Memorandumit të Mirëkuptimit) MM, përndryshe do të prekej mbështetja financiare.

Vlerësimi publik i dy muajve të parë të organizimit të ri të gjyqësorit në Portugali zbuloi qartë se efektet negative të kësaj reforme të nxituar do të zgjasnin për disa vite. Media raportoi për problematika tejet shqetësuese: softueri u rrëzua, duke i çuar gjykatat në një bllokim të plotë; ndërtesat nuk ishin të përgatitura për numrin e çështjeve dhe personelit që do të akomodonin; burimet njerëzore u shpërndanë në mënyrë jo-adekuate, duke lënë shumë gjykata me personel të shkurtuar; hapja e disa gjykatave të specializuara dhe shërbimeve të tjera gjyqësore në vende të largëta rezultoi kaotike, për shkak të

31 <https://estudogeral.sib.uc.pt/bitstream/10316/33099/1/The%20transition%20to%20a%20democratic%20Portuguese%20judicial%20system%20%28delaying%29%20changes%20in%20the%20legal%20culture.pdf>

32 https://www.researchgate.net/publication/326686070_Judicial_Reforms_%27Under_Pressure%27_The_New_MapOrganisation_of_the_Portuguese_Judicial_System

infrastrukturës së kufizuar të gjykatave kryesore, qytetarët dhe kompanitë morën informacion shumë të kufizuar. Vonesat në procedurat ligjore, vijimi njëkohësisht i proceseve gjyqësore dhe punimeve ri-konstruktuese, së bashku me pamundësinë e depozitimit të çështjeve për shkak të prishjes së softuerit, u bënë kryefjalë e përditshme e raportimeve. Ekspertët vlerësojnë se ende nuk janë vlerësuar ndikimet reale ligjore, as nuk janë llogaritur kostot financiare.³³

Që nga reforma e vitit 2013, Portugalia ka 23 gjykata kryesore/qarkut, një për secilin nga kryeqytetet e rretheve, me kompetencë për të vendosur për të gjitha çështjet që nuk janë dorëzuar në një gjykatë tjetër. Ato ndahen në seksione qendrore, në seksione të kompetencave të specializuara për fusha të ndryshme (hetimet civile qendrore, penale, familja dhe të miturit, marrëdhëniet e punës, tregtare dhe ekzekutimi i vendimeve), seksionet lokale, ato, të cilat përfshijnë seksione të përgjithshme (civile lokale, penale lokale dhe krime të vogla), dhe seksione të afërsisë. Në thelb, qeveria portugeze zgjodhi një model të bazuar në një gjykatë për rreth me seksione të ndryshme që funksionojnë në vendndodhje të ndryshme brenda distriktit. Këto seksione nuk janë gjykata autonome por degë të së njëjtës gjykatë. Ndërkohë që në vendin tonë, edhe pse degët e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm janë parashikuar në dy forma (si të përhershme dhe të përkohshme), në nenet 17 e në vijim të ligjit nr.98/2016, ato nuk u krijuan në kuadër të hartës së re gjyqësore.

Gjykatat me juridiksion më të gjerë territorial në Portugali ndahen sipas kompetencës lëndore në fushën e pronësisë intelektuale, konkurrencës, rregullimit dhe mbikëqyrjes detare, zbatimit të dënimeve dhe udhëzimi penal qendror – që do të thotë se ata që kanë kompetencë të specializuar dhe mund të dëgjojnë çështje që përfshijnë mjeshtra të veçantë. Kompetenca e tyre territoriale është më e gjerë se ajo e gjykatave të qarkut, pasi ato mund të shqyrtojnë çështje në disa rrethe ose në zona të veçanta të përcaktuara me ligj. Juridiksioni gjyqësor administrativ ushtrohet nga gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë dhe Gjykata e Lartë Administrative. Kjo e fundit, me seli në Lisbonë, me juridiksion mbi të gjithë territorin portugez dhe ndahet në dy seksione.

Referuar raporteve studimore dhe artikujve shkendorë të punuar nga ekspertë të fushës³⁴, disa problematika të përmbledhura mbi reformën e hartës gjyqësore në Portugali janë si vijon:

- a. Ky proces tregoi qartë favorizimin e ndarjes së gjykatave dhe shërbimeve të lidhura thjesht në bazë të përlllogaritjeve matematikore, pa marrë parasysh ngarkesën e çështjeve apo distancën e largët të zonave gjeografike si dhe sigurimin e barabartë të transportit publik dhe aksesit në rajone të ndryshme të vendit.
- b. Mungesa e planifikimit të ardhshëm dhe garancive të kushteve të përshtatshme fizike për të akomoduar shërbimet dhe burimet njerëzore, bëri që shumë gjykata të funksiononin pa kushtet minimale që mundësonin ushtrimin e duhur të veprimtarisë së tyre. Gjatë fazës së zbatimit, gjykatat i nënshtroheshin ende ri-konstruksionit, stafi punonte në zyrë të përkohshme modulare, ndërkohë që punësimi i përkohshëm për personelin përbënte gjithashtu një shqetësim në disa gjykata. Rrjedhimisht, motivimi i të punësuarve në sistemin gjyqësor u ul ndjeshëm, si dhe kapaciteti i tyre për të kryer punën e tyre sipas kompetencave dhe në mënyrë dhe dinjitoze. Në aspektin infrastrukturor, ambientet nuk garantonin hapësirë adekuate për të gjithë (stafi i brendshëm, avokatë, përdorues, shërbime mbështetëse, etj). Burimet në dispozicion sa i takon financave, pajisjeve, personelit dhe ndërtesat rezultuan në kushte shumë të pasigurta pune duke pasqyruar vendime për mbylljen e disa shërbimeve nga Autoriteti Portugez për Kushtet e Punës.

³³ <https://estudogeral.sib.uc.pt/bitstream/10316/33099/1/The%20transition%20to%20a%20democratic%20Portuguese%20judicial%20system%20%28delaying%29%20changes%20in%20the%20legal%20culture>

³⁴ Cituar në footnotes më sipër, në këtë seksion.



Pas evidentimit të këtyre problematikave, në vitin 2016 u tentua të merreshin një sërë masash për të korrigjuar gabimet më të dukshme të identifikuara në një vlerësim paraprak të reformës, me qëllim prezantimin e masave që do të afronin në mënyrë efektive drejtësinë me qytetarët. Për ta arritur këtë, Ministria e Drejtësisë propozoi ri-hapjen e 20 ambienteve të gjykatave të mbyllura, mbajtjen e detyrueshme të gjykimeve në 27 degët vendore dhe ndarjen e seksioneve qendrore të familjes dhe të të miturve. Shqetësimet e tjera të pasqyruara në ndryshimet e propozuara përfshinë trajtimin e pasojave të braktisjes së vazhdueshme të rajoneve të brendshme rurale me popullsi gjithnjë e më të plakur dhe përmirësimin e aksesit në sistemin e drejtësisë duke reduktuar distancat dhe kostot për ata që kërkojnë drejtësi. Këto masa, të konsideruara urgjente, synonin në thelb të përmbushin zotimin politik për të ri-hapur gjykatat e mbyllura nga qeveria e mëparshme, por nuk pasqyronin rezultatet e ndonjë vlerësimi të thelluar të reformës që përfshinte publikun. Deri në vitin 2018, u realizuan ndryshime dhe përmirësime të vogla, veçanërisht në infrastrukturë, të cilat nuk kanë pasur asnjë ndikim të rëndësishëm në funksionimin e përgjithshëm të sistemit gjyqësor.

Aksesi në drejtësi dhe në gjykata aktualisht³⁵ është i kufizuar nga shumë faktorë si kostot ligjore, kufizimet e ndihmës juridike dhe aksesit në shërbime të tjera ligjore, në veçanti në shërbimin e Prokurorisë Publike. Megjithatë, distanca fizike është gjithashtu një aspekt i rëndësishëm i aksesit dhe reformat e hartës gjyqësore nuk duhet të rëndojnë braktisjen e zonave të caktuara gjeografike. Ekspertët që kanë analizuar efektet e hartës gjyqësore në Portugali vlerësojnë se është e nevojshme të merret parasysh varfërimi i popullatës, asimetrisë gjeografike dhe vështirësitë dhe kostot e udhëtimit për palët dhe dëshmitarët gjatë gjithë procesit.

Procesi i zbatimit të reformës gjyqësore në Portugali, nën presionin e jashtëm, pakësoi mundësitë për të arritur objektivat e përcaktuara, qoftë në drejtim të përmirësimit të afërsisë dhe efikasitetit apo uljes së kostove.

Kaosi që pasoi dhe rezultatet e dukshme e të matshme tregojnë gabimet e strategjisë së miratuar dhe të modelit të zbatuar, me pasoja të rënda për funksionimin e sistemit gjyqësor dhe rrjedhimisht për qytetarët dhe bizneset që kërkojnë mbrojtje gjyqësore, të cilët vazhdojnë të presin përtej afateve të arsyeshme në gjykatat që kanë juridiksion të specializuar.

Një nga përfundimet e qarta është se një reformë nga lart-poshtë e rënduar nga kërkesat e jashtme të Trojkës, si pjesë e një marrëveshjeje për të ofruar mbështetje financiare për Portugalinë, duke shmangur e nënvlerësuar kontekstin social të territoreve të ndryshme dhe interesat më të gjera të qytetarëve, ka çdo potencial për të inkorporuar një praktikë të dëmshme për qytetarët dhe demokracinë.³⁶

³⁵I referohet vitit 2018.

³⁶https://www.researchgate.net/publication/326686070_Judicial_Reforms_%27Under_Presure%27_The_New_MapOrganisation_of_the_Portuguese_Judicial_System

5 Vlerësim i procesit të zbatimit në praktikë të ri-organizimit të ri gjyqësor në vendin tonë

5.1 Analizë e veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse

Sipas Vendimit nr.495, dt.21.07.2022, të Këshillit të Ministrave “Për ri-organizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave” janë parashikuar afate për riorganizimin e gjykatave si vijon:

- Për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm të cilat do të jenë gjithsej 13, riorganizimi do të realizohet më 1 Maj 2023.
- Për gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, riorganizimi në një gjykatë të vetme apeli në rang kombëtar do të realizohet në 1 Shkurt 2023.
- Për gjykatat administrative të shkallës së parë, të cilat do të jenë gjithsej 2, riorganizimi do të realizohet më 1 Korrik 2023.

Sikurse vihet re, afati më i shpejtë për riorganizimin e ri gjyqësor është vendosur për Gjykatat e Apelit, për të cilat është bërë edhe propozimi më drastik për shkrirje në raport me gjykatat e tjera.

Sipas pikës 4 të VKM nr.495, dt.21.07.2022, ngarkohen KLGJ, Prokurori i Përgjithshëm dhe Ministria e Drejtësisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi. Për të analizuar veprimtaritë konkrete të këtyre institucioneve për riorganizimin e ri gjyqësor brenda afateve të parashikuara, KShH ju drejtua fillimisht faqeve zyrtare për të marrë informacionin përkatës.

Edhe pse kishin kaluar 3 muaj e gjysme nga data e miratimit të VKM-së, në faqen e KLGJ-së pasqyrohej vetëm informacioni i lidhur me vlerësimin e hartës së re gjyqësore, por jo për zbatimin e VKM-së nr.495 (2022). Ndërkohë që vetë akti (VKM nr.495), i rëndësishëm për zbatimin e hartës së re gjyqësore, nuk gjendej i publikuar në faqen e të vetmit institucion të qeverisjes së gjyqësorit. Vlen të përmendet që KLGJ-së i është ngarkuar vlerësimi i Hartës Gjyqësore dhe riorganizimi i rretheve gjyqësore dhe rregullimi i kompetencave tokësore të gjykatave të rretheve gjyqësore, sipas neneve 13 e në vijim të Ligjit nr. 98/2016. Në vlerësimin e KShH-së kjo VKM është pjesë e kornizës ligjore që udhëheq veprimtarinë e këtij Institucioni, të cilit, për më tepër i janë caktuar përgjegjësi për zbatimin e tij. I njëjti konstatim u vërejt edhe për faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë si bashkëpropozuese për ri-organizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave si dhe për faqen



e Prokurorisë së Përgjithshme. Si rrjedhojë, kjo situatë nuk i shërben as transparencës së këtyre institucioneve karshi publikut.

Në mungesë të informacionit bazë që duhet të ishte publik në faqet e institucioneve, KShH ju drejtua me kërkesë zyrtare për informacion të trija institucioneve të sipërpërmendura, në fillim të muajit Nëntor të vitit 2022. KLGJ ka vendosur në dispozicion të KShH-së një informacion të pjesshëm të analizuar në vijim të këtij dokumenti. Ndërkohë që Ministria e Drejtësisë dhe Prokuroria e Përgjithshme reflektojnë përgjigje të pamjaftueshme në drejtim të kontributit që ato kanë dhënë si pjesë e GNP-së për zbatimin e hartës së re gjyqësore. Konkretisht:

Ministria e Drejtësisë, referon me shkresën me nr.prot 5833/1, dt.18.11.2022 se Ministri i Drejtësisë ka ngritur Grupin e punës me urdhërin nr.456, dt.20.09.2002 “Për verifikimin dhe inventarizimin e pronave dhe godinave në përdorim nga gjykatat e rretheve dhe gjykatat e apelit në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë”. Ministria e Drejtësisë nuk ka vendosur në dispozicion të KShH-së asnjë dokument apo informacion lidhur me detyrimin e zbatimit të pikës 4 të VKM nr.495, dt.21.07.2022 për Hartën Gjyqësore, që i bashkë-ngarkon kësaj Ministrie detyrimin e zbatimit të riorganizimit të ri gjyqësor. Në shkresën e saj, kjo Ministri ka referuar se për informacion më të hollësishëm mund t’i drejtoheni KLGJ që është institucioni kompetent për krijimin e hartës.

Përgjigja e Prokurorisë së Përgjithshme, me shkresën me nr.prot. 1514/1, dt. 30.11.2022 nuk mundëson gjithashtu dhënien e informacionit të konkretizuar dhe dokumentacionit lidhur me detyrimin e zbatimit të pikës 4 të VKM nr.495, dt.21.07.2022 për Hartën Gjyqësore. Ndër të tjerash, në shkresën e saj evidentohet se Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë urdhërin “Për ngritjen e grupit të punës për zbatimin e hartës së re gjyqësore në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, ku bëjnë pjesë edhe përfaqësues të prokurorive të apelit dhe prokurorive të shkallëve të para”. Gjithashtu, strukturat kompetente të Prokurorisë së Përgjithshme, në bashkëpunim dhe koordinim edhe me KLGJ dhe Ministrinë e Drejtësisë, pas miratimit të VKM nr.495, dt.21.07.2022 janë duke hartuar një plan masash administrative për të mundësuar funksionimin normal të prokurorisë nga ana infrastrukturore, me nisjen e zbatimit të hartës së re gjyqësore. Informacioni i dhënë është shumë i përgjithshëm dhe e pamundëson vlerësimin e hapave konkretë të punës së Prokurorisë së Përgjithshme, sa i takon përgjegjësi të realizuara prej saj, për zbatimin e hartës së re gjyqësore

5.2 Veprimtaria e KLGJ-së

5.0.1 Urdhëri nr.80, dt.28.07.2022 të Kryetares së KLGJ-së

KShH kërkoi të njihej me kopjen e urdhërit nr.80, dt.28.07.2022 të Kryetares së KLGJ-së, për ngritjen e GNP, për ndjekjen dhe zbatimin e VKM nr.495, dt.21.07.2022. Ky urdhër na u vendos në dispozicion me shkresën me nr. 5826/1, dt. 17.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Sipas përmbajtjes së tij, GNP përbëhet nga 13 anëtarë, 3 prej të cilëve anëtarë të KLGJ-së, dy përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, dy përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme, 2 magjistratë gjyqësorë (përkatesisht nga GJKKO e Apelit dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë), 1 kancelar nga Gjykata e Apelit Tiranë, si dhe 3 përfaqësues të nivelit të lartë të administratës së KLGJ-së.

Nga përmbajtja e shkresës së KLGJ rezulton se përbërja e këtij grupi pune është rivitalizuar, çka nënkupton që një pjesë e anëtarëve të tij janë të njëjtët me anëtarët e GNP që bëri vlerësimin e nevojave

të organizimit të ri gjyqësor. Është e paqartë se mbi bazën e cilave kritereve janë përzgjedhur anëtarët e GNP, përfaqësues në radhët e sistemit gjyqësor, nëse ka patur një proces përzgjedhjeje dhe vlerësimi të kandidatëve, duke u bazuar në një proces gjithëpërfshirës dhe meritokratik.

Sipas pikës II të këtij urdhëri, në grupin e punës ftohen të marrin pjesë përfaqësues nga Këshilli i Evropës në kuadër të projektit “Për uljen e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit të Gjykatës së Lartë”.

Tërheq vëmendjen fakti se edhe në këtë GNP (ashtu si GNP për vlerësimin e nevojave të hartës së re gjyqësore), nuk janë ftuar të marrin pjesë qoftë në cilësinë e vëzhguesit, përfaqësues të organizatave vendase të shoqërisë civile të angazhuara me nisma në fushën e sistemit të drejtësisë, pedagogë, avokatë, ekspertë vendas të ligjit në fushën e drejtësisë. Reflektimi i kësaj qasje të hapur bashkëpunuese, për çështje madhore sikurse është harta e re gjyqësore, duhet të ishte ndër prioritetet kyçe të Këshillit, pasi duhet të vinte edhe si pasqyrim i përbërjes së KLGJ, me përfaqësi jo vetëm nga sistemi gjyqësor por edhe nga avokatia, shoqëria civile, shkolla e magistraturës, fakultetet e drejtësisë.

5.0.2 Plani i Veprimit për Gjykatat e Apelit

Sipas pikës VI të urdhërit nr.80, dt. 28.07.2022 të Kryetares së KLGJ, GNP duhet të përfundonte brenda datës 30 Nëntor 2022 të gjitha aktet e nevojshme për zbatimin e hartës së re gjyqësore. Deri në dt.17 Nëntor 2022 janë zhvilluar disa mbledhje të këtij grupi, ku fillimisht është dakordësuar Plani i Veprimit për gjykatat e apelit dhe afatet kohore për çdo veprim. Tërheq vëmendjen fakti se Plani i veprimit që ishte objekt i kërkimit në kërkesën për informacion të KShH-së, nuk u vendos në dispozicion nga KLGJ-ja.

Në zbatim të këtij plani, rezulton se janë krijuar gjashtë nëngrupe pune, të cilët kanë punuar në gjashtë drejtime kryesore për ri-organizimin e ri gjyqësor, si vijon:

- Nëngrupi I “Burimet Njerëzore/Gjyqtarët”
- Nëngrupi II “Burimet Njerëzore/Administrata Gjyqësore”
- Nëngrupi III “Godina dhe Infrastruktura”
- Nëngrupi IV “Teknologjia e Informacionit”
- Nëngrupi V “Administrimi Gjyqësor”
- Nëngrupi VI “Informimi i Publikut dhe Komunikimi”

Sipas KLGJ-së, nga nëngrupet e punës janë zhvilluar mbledhje të vazhdueshme, të cilat kanë patur në fokus hartimin e projekt-akteve të nevojshme për fillimin e zbatimit të hartës, me qëllim kalimin e tyre në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit nga mbledhja plenare e KLGJ-së. Në fakt, asnjë prej këtyre projekt-akteve (në variantin draft) nuk rezulton të jetë publikuar në faqen zyrtare të KLGJ-së, duke mos u pajtuar me nevojat e transparencës dhe informimit të publikut që për më tepër, përbën edhe një nga shtyllat e veçanta të veprimtarisë së nëngrupeve të punës.

Në shkresën kthim përgjigje drejtuar KShH-së, pranohet nga KLGJ se çdo akt që do jetë produkt i punës së GNP do të bëhet publik vetëm pasi të jetë shqyrtuar dhe miratuar nga KLGJ. Në këtë drejtim, është e paqartë se përse projekt akte të tilla nuk publikohen në formën që i propozohen KLGJ-së, ndërkohë që konfidencialiteti i tyre nuk i shërben transparencës së publikut por edhe besimit të këtij të fundit në procesin e organizimit të ri gjyqësor.

5.0.3 Korrespondenca e munguar e KLGJ-së me institucionet, për zbatimin e hartës së re gjyqësore

KShH i kërkoi gjithashtu KLGJ-së të njihej me *çdo kopje zyrtare të korrespondencës shkresore me institucionet përkatëse, në funksion të ngritjes së grupit të punës dhe nëngrupeve* për jetësimin e hartës së re gjyqësore. Në mënyrë të veçantë, KShH kërkoi *të njihet me korrespondencën e mbajtur me gjykatat, nëse ka një të tillë, pas miratimit të VKM-së nr.495, në funksion të riorganizimit gjyqësor (për vlerësimin e shtyllave kryesore të punës).*

Në përgjigjen e saj, KLGJ referon se ka shmangur korrespondencën zyrtare me institucionet, të cilat janë përfaqësuar në GNP, që përbën edhe një strukturë gjithëpërfshirëse që ka synuar mirëfunksionimin dhe efektivitetin e ndërveprimit dhe shkëmbimit të informacionit, të nevojshëm për realizimin e objektivave të çdo faze të procesit. Sipas KLGJ-së, GNP siguron një përfaqësi të të gjitha niveleve të gjykatave që preken nga organizimi, ndërkohë që në fakt kjo e dhënë është kontradiktore pasi GNP ka vetëm dy anëtarë magjistratë në radhët e sistemit gjyqësor përkatësisht nga GJKKO dhe Gjykata e një rrethi gjyqësor.

KShH vlerëson se emërimi i anëtarëve të GNP nga institucionet e tjera (Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, gjykatat) si dhe korrespondenca me gjykatat në funksion të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave për gjashtë drejtimet mbi të cilat është punuar për zbatimin e hartës, duhet të kishte karakter zyrtar dhe rrjedhimisht të dokumentohej, me qëllim që të ishte e verifikueshme për çdo të interesuar lidhur me etapat e zbatimit të hartës gjyqësore. Në këtë drejtim, vlen të theksohet se KLGJ kishte në dispozicion një kohë relativisht të arsyeshme për jetësimin e hartës së re gjyqësore, që parashikonte si afatin e parë dt.1 Shkurt 2023 për riorganizimin e gjykatës së apelit në rang kombëtar (ose afro 6 muaj nga data e VKM nr. 495). Në përfundim, KShH vlerëson se dokumentimi i nevojave të gjykatave si rrjedhojë e procesit të zbatimit të hartës së re gjyqësore do ti shërbente gjithashtu transparencës dhe besimit karshi publikut.

5.0.4 Kopjet e procesverbaleve të GNP

KShH, në kërkesën për informacion drejtuar KLGJ-së kërkoi gjithashtu të njihej me kopje të procesverbaleve të mbledhjeve javore të GNP, nëse ato janë zbardhur në mënyrë të përmbledhur ose të detajuar. Në shkresën kthim përgjigje të KLGJ, dt. 17 Nëntor 2022, jemi informuar se gjatë zhvillimit të mbledhjeve të GNP është mbajtur procesverbal i detajuar, i cili i është njoftuar anëtarëve të GNP-së. Kjo praktikë është ndjekur me qëllim përdorimin e brendshëm dhe për efekt të mbledhjes dhe përpunimit të mendimeve, konstatimeve apo sugjerimeve të dhëna nga ana e tyre, që do të reflektoheshin më pas, në hartimin përfundimtar të projek-takteve dhe relacioneve të tyre shoqëruese, gjatë fazës së miratimeve të tyre në Këshill. KLGJ nuk vendosi në dispozicion të KShH-së kopje të këtyre procesverbaleve, duke i konsideruar ato si materiale për përdorim të brendshëm. Ky kufizim është jo legjitim pasi bie ndesh me dispozitat e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “Informacion publik” është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik (në rastin konkret nga një organ ad hoc i ngritur nga KLGJ, me natyrë këshillimore). Bazuar në nenin 3 të këtij ligji, çdo person gëzon të drejtën e njohjes me procesverbalet e GNP, të cilat kanë statusin e informacionit publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.

Në përfundim, KShH vëren se GNP për ndjekjen dhe zbatimin e hartës së re gjyqësore ka shfaqur mungesë transparence dhe aksesin të përfaqësuesve të shoqërisë civile në mbledhjet e tij, rrjedhimisht edhe mungesë të një procesi gjithëpërfshirës përgjatë fazës së hartimit të akteve të nevojshme për konkretizimin e hartës së re gjyqësore. Vlerësojmë si tejet problematikë, qasjen e treguar nga KLGJ për mungesën e dokumentacionit zyrtar për shkëmbimin e të dhënave me gjykatat dhe institucionet e tjera të përfaqësuara në GNP për zbatimin e hartës së re gjyqësore si dhe mohimin e paarsyeshëm të aksesit në informacion për Planin e Veprimit dhe procesverbalet e GNP-ve, ndaj një organizate monitoruese të njohur të sistemit të drejtësisë sikurse është KShH.

5.0.5 Aktet e miratuara nga KLGJ për jetësimin e hartës së re gjyqësore

a) Aktet normative nënligjore

- Vendimi nr. 505, datë 21.11.2022 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”

Ky është akti i parë nënligjor i miratuar nga KLGJ që i hap rrugë funksionimit të së vetmes Gjykatë Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm në vendin tonë.

Sipas përmbajtjes së tij, gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në gjykatën e apelit Tiranë qëndron në pozicion në strukturën e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Në vendim parashikohet gjithashtu ndërprerja e veprimtarisë së Gjykatave të Apelit Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, më datë 31.01.2023. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në këto gjykata të shkruara të apelit i suprimohet pozicioni për shkak të riorganizimit gjyqësor dhe transferohet në pozicion të përhershëm në strukturën e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Pozicionet e shpallura për ngritje në detyrë në gjykatat e apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, për të cilat në datën 1.02.2023 nuk ka përfunduar ende procedura e ngritjes në detyrë, konsiderohen pozicione të lira të përhershme në strukturën e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Akti parashikon gjithashtu rregullim edhe për vazhdimësinë e punës së administratës gjyqësore. Konkretisht, administrata gjyqësore e Gjykatës së Apelit Tiranë, e përbërë nga punonjësit që ushtrojnë shërbimet gjyqësore, administrative dhe mbështetëse sipas përcaktimit të ligjit, vijon të ushtrojë veprimtarinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe nuk i nënshtrohet procesit të ristrukturimit. Administrata gjyqësore e gjykatave të apelit Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë i nënshtrohet procesit të ristrukturimit. Përfundim nga ky rregull bëjnë ndihmësit ligjor me emërim përfundimtar në gjykatat e apelit Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, të cilit i suprimohet pozicioni për shkak të riorganizimit gjyqësor, por transferohet në mënyrë të përhershme në strukturën e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Është e paqartë se përse është bërë ky diferencim në vijueshmërinë e pozicionit të punës së ndihmësve ligjorë ndërkohë që për nëpunësit e tjerë të tjera gjykatave që propozohen të shkrihen kalohet në proces ristrukturimi. Ky vendim duhej të shoqërohej me një relacion shpjegues të nevojave dhe që qartësonte për publikun dhe të interesuarit, elementë të rëndësishëm të përmbajtjes së tij, sikurse është edhe vazhdimësia e punës së punonjësve të administratës dhe atyre gjyqësor të gjykatave të shkruara.

Parashikime të veçanta ka edhe për ndarjen e çështjeve gjyqësore të Gjykatave të Apelit që shkrihen. Çështjet gjyqësore të regjistruara në Gjykatën e Apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë deri në datën 31.01.2023, por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit, transferohen në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Këto çështje regjistrohen në regjistrat manualë dhe sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve ICMIS. Çështjet gjyqësore të transferuara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm rindahen me short elektronik, në përputhje me kriteret e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Çështjet gjyqësore të transferuara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për të cilat ka filluar apo është planifikuar shqyrtimi gjyqësor në gjykatat e apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, nuk i nënshtrohen rindarjes me short. Këto çështje do të vijojnë të shqyrtohen nga të njëjtët gjyqtarë. Për efekt të riorganizimit, transferimit dhe menaxhimit të çështjeve, planifikimi i datave për gjykimin e çështjeve gjyqësore në gjykatat e apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, bëhet deri në 31.12.2022.

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda muajit shkurt 2023, mbështetur në legjislationin në fuqi, përmbush të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga mbyllja në datë 31.01.2023 e aktivitetit ekonomik financiar të gjykatave të apelit. KShH vëren se ky parashikim nuk është shoqëruar me një kosto financiare dhe nënkategorizim të vlerësimit të detyrimeve dhe mënyrën se si ato do të përmbushen nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, dhe mbi të gjitha, nëse kjo e fundit e ka ose jo në dispozicion buxhetin që shlyen këto detyrime.

- *Vendimi nr.554, datë 29.12.2022 "Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore"*³⁷

Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i kriterëve dhe rregullave të hollësishme për ndarjen e çështjeve gjyqësore me short, në të gjitha nivelet e gjykatave në Republikën e Shqipërisë. Rastet dhe kriteret e rindarjes së çështjeve me short, pritet të rregullohen me një akt të veçantë të KLGJ-së. Ndarja e çështjeve gjyqësore me short realizohet me anë të algoritmeve, mbi bazën e parimit të transparencës, informimit, kontrollit, mbikëqyrjes, gjurmimit, barazisë së shpërndarjes dhe objektivitetit dhe duke mundësuar autenticitetin e shortit, integritetin e të dhënave, sigurinë dhe auditimin e tyre.

Sistemi elektronik i shortimit pritet të prodhojë raporte periodike të auditimit ose mbi bazë të kërkesave për auditim (gjurmim) nga KLGJ ose ILD. Çështjet gjyqësore, me paraqitjen në gjykatë, regjistrohen menjëherë në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve nga sekretaria gjyqësore, sipas kategorive të sistemit, nën mbikëqyrjen e kryesekretarit dhe kancelarit. Ndarja e çështjeve me short, si rregull, realizohet çdo ditë pune në rrugë elektronike me anë të sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Procesi i shortimit për ndarjen e çështjeve realizohet në sallë gjykimi dhe shfaqet në kohë reale në monitorët e vendosur në ambientet e hyrjes së gjykatës për aq sa është e mundur. Raporti i shortimit është publik dhe pasqyrohet menjëherë në faqen zyrtare të internetit të gjykatës. Çështjet gjyqësore u ndahen në mënyrë të barabartë gjyqtarëve, sipas organizimit të brendshëm të gjykatës.

Sipas përmbajtjes së këtij vendimi shorti elektronik cakton gjyqtarin e çështjes, i cili është kryetari i trupit gjykues ose gjyqtarin relator, në rastet kur çështja gjykohet me trup gjykues. Është e paqartë sipas këtij formulimi nëse shorti mundëson dhe zgjedhjen e anëtarëve të tjerë të trupit gjykues, kur çështja gjykohet në panele me tre ose më shumë gjyqtarë.

Gjithashtu, vlen të theksohet se në rastin kur sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve nuk

³⁷ <https://klgj.al/wp-content/uploads/2023/01/VENDIM-Nr.554dat%C3%AB-29.12.2022-P%C3%8BR-NDARJEN-ME-SHORT-T%C3%8B-%C3%87%C3%8BSHTJEVE-GJYQ%C3%8BSORE.pdf>

funksionin në mënyrë të dokumentuar, për më shumë se dy ditë pune, ndarja e çështjeve realizohet përmes shortit manual.

Pavarësisht parashikimeve në vendimin nr.505, dt.21.11.2022, KShH vëren se do të ishte e nevojshme në funksion të parimit të qartësisë, që ky akt të kishte një rregullim tranzitor të posaçëm lidhur me çështjet e transferuara në Gjykatën e vetme të Apelit me juridiksion të përgjithshëm, nga gjykatat që shkrihen.

- Vendimi nr. 556, datë 29.12.2022 “Mbi miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm”³⁸

Kjo rregullore, së bashku me anekset shoqëruese, parashikon rregulla standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Qëllimi i saj është plotësimi i bazës ligjore për organizimin dhe funksionimin e strukturës së brendshme të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për të bërë të mundur funksionimin sa më efektiv, profesional dhe transparent të veprimtarisë së kësaj gjykate.

Struktura organizative e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm përbëhet nga 245 funksionarë/punonjës, të kategorizuar si vijon:

- a) Kryetari i Gjykatës (1);
- b) Trupa gjyqësore (77 vende);
- c) Kancelari (1 vend);
- d) Njësia e Shërbimit Ligjor (32 vende);
- e) Kryesekretari (2 vende);
- f) Sekretaria Gjyqësore (82 vende);
- g) Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar (6 vende);
- h) Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve (22 vende);
- i) Sektori i Teknologjisë së Informacionit, Statistikave, Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë (4 vende);
- j) Sektori i Protokollit dhe Arkivës dhe Koordinimit të Zyrave të Shërbimit (18 vende)

Sipas nenit 14, pika 3 dhe 4 të këtij vendimi parashikohet ngritja dhe funksionimi i zyrave të shërbimeve në 5 qytetet ku janë gjykatat e shkrija të apelit, përkatësisht në Durrës, Korçë, Gjirokastrë, Vlorë dhe Shkodër. Qëllimi i funksionimit të këtyre zyrave është ofrimi i shërbimeve administrative që lidhen me protokollin dhe arkivin gjyqësor. Dy nëpunësit civilë gjyqësorë që ushtrojnë funksionet pranë zyrave të shërbimeve në rrethe, marrin në dorëzim dhe përcjellin pa vonesë për trajtim në strukturën qendrore të shërbimeve gjyqësore ose administrative të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, çdo kërkesë ose dokument që paraqitet nga palët në një proces gjyqësor, përfaqësuesit ligjorë, përdoruesit e tjerë të gjykatës si dhe çdo subjekt tjetër i interesuar. Gjithashtu, këta punonjës kryejnë të gjitha detyrat e sekretarit gjyqësor si dhe veprimet që lidhen me administrimin e dosjeve gjyqësore të çështjeve të përfunduara deri në datën 31 janar 2023, të tilla si komunikimi i vendimeve gjyqësore palëve ndërgjyqëse, komunikimi i rekursit/kundër-rekursit palëve ndërgjyqëse në çështjet

³⁸ <https://klgj.al/wp-content/uploads/2023/01/VENDIM-Nr.-556-dat%C3%AB-29.12.2022-MBI-MIRATIMIN-E-RREGULLAVE-STANDARDE-P%C3%8BR-ORGANIGRAM%C3%8BN-P%C3%8BRSHKRIMIN-E-DETYRAVE-DHE-P%C3%8BRGJEGJ%C3%8BSIVE-T%C3%8B-POZICIONEVE-T%C3%8B-N%C3%8BPUN%C3%8BSVE-CIVIL%C3%8B-GJYQ%C3%8BSOR%C3%8B-DHE-PUNONJ%C3%8BSVE-T%C3%8B-TJER%C3%8B-T%C3%8B-GJYKAT.pdf>

civile dhe përcjelljen e dosjes gjyqësore me aktet e plota për vlerësim nga gjyqtari relator në lidhje me lejimin e rekursit, etj.

Në aneksin B të këtij vendimi është detajuar përshkrimi standard i detyrave dhe të përgjegjësive për secilin pozicion të nëpunësve civilë gjyqësorë të gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm.

b) Aktet Kolektive të KLGJ

– *Vendimi nr. 553, datë 29.12.2022 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm”*³⁹

Me anë të këtij vendimi, KLGJ ka vendosur që numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është 78 (shtatëdhjetë e tetë) gjyqtarë. Sikurse do të vërehet edhe nga relacioni shoqërues për miratimin e raportit vlerësues të hartës së re gjyqësore, ky numër përbën shumatoren e numrit të gjyqtarëve të gjashtë gjykatave të mëparshme të apelit, sipas organikës së miratuar me dekret të Presidentit të afro 10 viteve më parë.

Sipas vlerësimit të nevojave të hartës së re gjyqësore, GNP pranon se analiza statistikore e ngarkesës së gjashtë gjykatave të apelit kryhet mbi premisat se gjykata e vetme e apelit të juridiksionit të përgjithshëm do të funksiononte me një transferim mekanik të të gjithë gjyqtarëve të apelit në një gjykatë të vetme⁴⁰. Më tej, GNP vlerëson se nëse gjashtë gjykatat e apelit, do të kishin funksionuar si një gjykatë e vetme, atëherë do të kishim një ngarkesë totale prej 39,882 çështje, e cila do të shpërndahej mes 38.2 gjyqtarëve efektivë. Këto të dhëna do të rezultonin në një tregues ngarkesë mesatare për gjyqtar prej 1215.9 çështjesh. Sikurse vërehet, analiza është realizuar jo mbi bazën e numrit total të gjyqtarëve të miratuar për gjykatën e vetme të apelit, por me numrin e gjyqtarëve efektivë që kjo gjykatë ka patur në vitin 2021, që është afro gjysma e tyre. Ndërkohë që me fillimin e funksionimit të saj, numri ka zbritur në 25 gjyqtarë, ose 13.2 gjyqtarë më pak se vlerësimi që KLGJ i ka bërë ngarkesës së gjykatës së vetme të Apelit⁴¹.

Sa më sipër, KShH vëren se kjo analizë nuk është e plotë dhe është krejtësisht matematikore ndërkohë që KLGJ duhet të vlerësonte paralelisht edhe hapësirën e plotësimit të vakancave në Gjykatën e Apelit, duke parë ecurinë (trendin) e procesit të vettingut por edhe të numrit dhe hapësirës së gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses këtë proces për t’u promovuar në gjykatën e Apelit, duke marrë në konsideratë edhe prurjet e reja nga Shkolla e Magjistraturës për Gjykatat e Shkallës së Parë.

– *Vendimi nr. 555, datë 29.12.2022 “Për rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në gjykatat e rretheve gjyqësore”*⁴²

Me anë të këtij vendimi, KLGJ ka vendosur të miratojë rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, si dhe të pezullojë të gjitha procedurat e rekrutimit, për

39 <https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/12/VENDIM-Nr.-553-dat%C3%AB-29.12.2022-P%C3%8BR-CAKTIMIN-E-NUMRIT-T%C3%8B-GJYQATAR%C3%8BVE-N%C3%8B-GJYKAT%C3%8BN-E-APELIT-T%C3%8B-JURIDIKSIONIT-T%C3%8B-P%C3%8BRGJITHSH%C3%8BM.pdf>

40 Fq.17, shih relacionin e publikuar në këtë link:

<https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/06/relacion-harta-gjyqesore-F-1-Mbledhje-Plenare.pdf>

41 <https://shqiptarja.com/lajm/nga-sot-vetem-1-gjykate-apeli-ne-tirane-shkrihen-5-te-tjera-ne-rrethe-32-mije-dosje-ne-prijte>

42 <https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/12/VENDIM-Nr.-555-dat%C3%AB-29.12.2022-P%C3%8BR-RISHP%C3%8BRNDARJEN-E-NUMRIT-T%C3%8B-POZICIONEVE-T%C3%8B-PUN%C3%8BS-N%C3%8B-GJYKAT%C3%8BN-E-APELIT-T%C3%8B-JURIDIKSIONIT-T%C3%8B-P%C3%8BRGJITHSH%C3%8BM-DHE-N%C3%8B-GJYKATAT-E-RRETHEVE-GJYQ%C3%8BSORE.pdf>

plotësimin e vendeve vakante për të gjithë kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë, deri në përfundimin e procesit të ristrukturimit.

Tërheq vëmendjen fakti se për administratën gjyqësore në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, planifikimi nuk është bërë për 13 gjykata të cilat do të funksionojnë nga dt.1 Maj 2023, por për 16 gjykata, ku janë parashikuar edhe gjykatat e shkriira si ajo e Pogradecit, Lushnjës, Kavajës dhe Matit. Në total, për këto gjykata që janë pjesë e aneksit të vendimit të KLGJ-së parashikohet një numër total i administratës gjyqësore prej 558 pozicioneve, ose 21 më shumë në raport me strukturën e mëparshme të stafit. Në këtë organikë të re nuk është shtuar numri i personelit të gjykatave që propozohen të shkrihen, përkundrajt asaj që parashikohet në raportin e vlerësimit të GNP. Sipas tij, Harta e Re Gjyqësore nuk sjell pakësim të burimeve njerëzore, pavarësisht uljes së numrit të gjykatave. Kjo vjen për shkak se numri i çështjeve gjyqësore për gjykim nuk pakësohet, përkundrazi ato vijnë në rritje për çdo vit⁴³.

Nëse krahasojmë të dhënat e raportit vlerësues të Hartës së Re gjyqësore me strukturën organizatave për secilën gjykatë të rretheve gjyqësore, bazuar në vendimin nr.555, dt.29.12.2022 të KLGJ vërehet se suprimohen një numër i konsiderueshëm pozicioneve në gjykatat që do të shkrihen. Konkretisht, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka një organikë prej 43 punonjësish, ndërkohë që sipas raportit të vlerësimit parashikohej një organikë prej 52 punonjësish (12 prej të cilëve i përkisnin gjykatës së shkriurë të Kavajës). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka një organikë të miratuar prej 17 punonjësish, ndërkohë që sipas raportit të vlerësimit parashikohej një organikë me 28 punonjës administrate (11 prej të cilëve i përkisnin gjykatës së shkriurë të Përmetit). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës për të cilën GNP ka parashikuar 25 punonjës administrate (13 + 12 nga Gjykata e Tropojës) nuk figuron në shtojcën e vendimit të KLGJ-së. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka një organikë prej 20 punonjës administrate të miratuar nga KLGJ, ndërkohë që sipas raportit të vlerësimit parashikohej një organikë me 35 punonjës, prej të cilëve 15 i përkisnin Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, etj. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka një organikë të miratuar prej 34 punonjësish administrativë, ndërkohë që sipas raportit të vlerësimit parashikohej një organikë prej 46 punonjës administrate, prej të cilëve 12 i përkisnin Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, të shkriurë, etj.

– *Vendim nr. 557, datë 29.12.2022 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisioneve të ristrukturimit”⁴⁴*

Vendimi ka për objekt përcaktimin e rregullave të detajuara të krijimit dhe funksionimit të Komisioneve të Ristrukturimit që ngrihen në kuadër të riorganizimit të kompetencave tokësore të gjykatave si dhe të procedurave të verifikimit të kushteve dhe kriterëve që duhet të plotësojnë nëpunësit civilë gjyqësorë si dhe punonjësit e tjerë gjyqësorë, që i nënshtrohen ristrukturimit për shkak riorganizimi. Komisioni i Ristrukturimit përbëhet nga kryetarët dhe kancelarët e gjykatave që shkrihen dhe atyre që i përthithin ose gjykatës pritëse (p.sh. për Gjykatën e vetme të Apelit përbëhet nga të gjithë kryetarët dhe kancelarët e 6 gjykatave të apelit) dhe drejtohet nga një përfaqësues i KLGJ-së. Këto Komisione shqyrtojnë mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil gjyqësor dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë të gjykatave që i nënshtrohen riorganizimit, në strukturën dhe organikën e gjykatës pritëse, apo edhe në pozicione të së njëjtës kategori, në gjykata të tjera.

Kancelari i çdo gjykate, menjëherë pas krijimit të Komisionit të Ristrukturimit, njofton individualisht çdo nëpunës të gjykatës për fillimin e procedurës së ristrukturimit. Gjithashtu, kancelari vendos

43 Shih faqen 23 të relacionit: <https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/06/relacion-harta-gjyqesore-F-1-Mbledhje-Plenare.pdf>

44 <https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/12/VENDIM-Nr.-557-dat%C3%AB-29.12.2022-%E2%80%9CP%C3%8BR-KRIJIMIN-FUNKSIONIMIN-DHE-KOMPETENCAT-E-KOMISIONEVE-T%C3%8B-RISTRUKTURIMIT.pdf>

në dispozicion të Komisioneve të Ristrukturimit përshkrimet e punës së pozicioneve dhe kriteret specifike, kopje të dosjes personale, etj. Brenda 15 ditëve nga krijimi, Komisioni përfundon procesin e vlerësimit dhe miraton vendimin propozues për transferimin e përhershëm të të gjithë nëpunësve të gjykatës, bazuar në elementë si krahasimi i strukturës së gjykatës pritëse me strukturën ekzistuese, verifikimin e përshkrimeve të punës, verifikimin e dosjeve personale të nëpunësve civilë gjyqësorë për të evidentuar përvojën profesionale/arsimimin si dhe largësinë e vendbanimit më shumë se 45 km nga institucioni, dokumentin përkatës të nëpunësit civil gjyqësor me probleme shëndetësore të vërtetuara me raportin përkatës mjekësor.

Në parim, KShH vlerëson se afati 15 ditor që i është lënë në dispozicion Komisioneve të Strukturimit për të bërë vlerësimin e këtij dokumentacioni nuk duket i arsyeshëm. Kjo duke patur në konsideratë numrin e konsiderueshëm të punonjësve që i nënshtrohen këtij vlerësimi. Komisioni i Ristrukturimit për Gjykatat e Apelit rezulton se është krijuar me vendimin nr. 2, datë 11.01.2023 ose afro 2 javë më vonë pas miratimit të vendimit nr.557, dt. 29.12.2022⁴⁵, duke mos respektuar në këtë mënyrë afatin 2 ditor të parashikuar në pikën 1, neni 2 të këtij vendimi (që fillon nga data e botimit të tij, 30 Dhjetor 2022). Megjithatë, duke patur parasysh edhe dy ditët zyrtare të pushimit (1 dhe 2 Janar 2023), KShH vendos një theks të veçantë tek kompleksiteti i punës së Komisioneve të Ristrukturimit, të cilat duhet të ngriheshin së paku brenda muajit Nëntor të vitit që lamë pas (2022). Rrjedhimisht, edhe aktet kolektive që mundësonin ngritjen e tyre duhet të ishin të pakën një muaj më të hershme në kohë.

Vendimi propozues i Komisionit të Ristrukturimit, për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil gjyqësor i dërgohet Këshillit aktual të gjykatës pritëse, kurse për kancelarët vendimi propozues i dërgohet KLGJ-së. Ky vendim identifikon pozicionin në strukturën e gjykatës pritëse, ose sipas rastit në gjykata të tjera, apo përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil gjyqësor. Nga përmbajtja e këtij parashikimi, KShH vëren se është e diskutueshme vendimmarrja për propozimet e Komisionit të Ristrukturimit vetëm tek Këshillat aktualë të gjykatës pritëse. Gjithashtu, në kuptim të sigurisë juridike të punonjësve në gjykata dhe parimit të vazhdimësisë së tyre në punë, është e paqartë sipas këtij vendimi, se cilat janë rastet kur Komisioni mund të propozojë përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil gjyqësor.

Sipas vendimit, nëpunësi mund ta refuzojë transferimin vetëm në rastet kur gjendja e tij shëndetësore, e provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur ose kur gjykata ku i propozohet të transferohet gjendet më shumë se 45 km nga vendbanimi i nëpunësit civil. Refuzimi nga ana e nëpunësit e vendimit propozues të transferimit të përhershëm për arsye të tjera nga këto, përbën shkak për lirimin nga shërbimi civil gjyqësor. Lidhur nga mënyra e formulimit të këtyre parashikimeve, duket se për punonjësit që kanë shkak ligjor të refuzimit të pozicionit me transferim, nuk do të lirohen nga shërbimi civil gjyqësor. Nëse është kështu, në kuptim të vazhdimësisë ky është një element pozitiv por që kërkon një rregullim tranzitor në vendimmarrjet e KLGJ-së, për sa kohë do të qëndrojnë në shërbimin civil gjyqësor, niveli i pagës që do të marrin dhe prioritarizimi i nevojës për tu sistemuar nga organet përkatëse, sipas ligjit nr.98/2016.

I paqartë është gjithashtu edhe statusi i punonjësve të tjerë gjyqësorë të gjykatave që shkrihen, pasi vendimi parashikon se lidhur me ta, zbatohen për aq sa është e mundur, parashikimet e këtij vendimi si dhe dispozitat e Kodit të Punës. Kjo paqartësi reflekton në drejtim të raportit të parashikimeve të këtij vendimi me nenet e Kodit të Punës, të cilat për më tepër, nuk janë referuar në përmbajtjen e tij. Gjithashtu, në funksion të parimit të vazhdimësisë, vendimi duhet ti jepte prioritet në formulimin e këtij parashikimi marrjes së të gjitha masave për të bërë të mundur sistemimin në punë të ngjashme

⁴⁵ <https://klgj.al/wp-content/uploads/2023/01/VENDIM-NR.-2-DAT%C3%8B-11.01.2023-P%C3%8BR-KRIJIMIN-E-KOMISIONIT-T%C3%8B-RISTRUKTURIMIT-T%C3%8B-GJYKATAVE-T%C3%8B-APELIT.pdf>

ose ekuivalente të punonjësve të tjerë gjyqësore. Epërsia e kësaj nevoje vjen edhe si detyrim i nenit 13, pika 4 të ligjit nr.98/2016 për organizimin e pushtetit gjyqësor, ku parashikohet se procesi për caktimin ose caktimi rishtas i rretheve gjyqësore dhe i kompetencave tokësore të gjykatave kryhet duke marrë në konsideratë gjithashtu, nevojën për vazhdimësi të shërbimeve gjyqësore, transferimin e personelit dhe organizimin e logjistikës.

Në funksion të transparencës karshi publikut dhe punonjësve të gjykatave të shkrira, sa i takon efekteve të hartës së re gjyqësore duke filluar nga gjykatat e apelit, KShH vlerëson se në faqen zyrtare të KLGJ-së duhet të pasqyroheshin të dhëna të përpunuara dhe të kategorizuara për numrin dhe pozicionet e punonjësve të transferuar në kuadër të ristrukturimit, ku janë transferuar, nëse kanë refuzuar transferimin cilat janë shkaqet si dhe ata ndaj të cilëve është vendosur përfundim i marrëdhënies së punës, dhe shkaqet që justifikojnë këto vendime.

c) Aktet Individuale të KLGJ

Gjatë këtyre muajve, KLGJ rezulton se ka marrë disa vendime, në formën e akteve individuale, për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarëve për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku janë caktuar në mënyrë të përhershme. Pozitiv është fakti që gjyqtarëve j'u është dhënë mundësia për tu transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e të njëjtit nivel e së njëjtës lëndë me pozicionin e mëparshëm, duke i lënë mundësinë e të drejtës së zgjedhjes. Megjithatë, lidhur me ushtrimin e kësaj të drejte, afati tre ditor që i lihet në dispozicion magjistratit për të pranuar një nga këto pozicione, në vlerësimin e KShH-së nuk është i mjaftueshëm⁴⁶.

Në kuptim të kriterëve që kanë udhëhequr KLGJ-në për të propozuar për secilin magjistrat që ka një pozicion të përhershëm në gjykatën që shkrihet, është e paqartë si janë përzgjedhur gjykatat e rretheve gjyqësore për të cilat bëhet propozimi për transferim të secilit prej tyre. E themi këtë pasi, për shembull, duke marrë në konsideratë një nga vendimet e fillimit të procedurës së transferimit për shkak të suprimimit të një gjyqtareje në Gjykatën e Lushnjës⁴⁷ ose të Gjykatës së Kurbinit, propozimi është bërë për katër vende vakante përkatësisht dy në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dy pranë asaj të Durrësit. Ndërkohë, Gjykata e Lushnjës sipas ri-organizimit të ri gjyqësor do të përthithet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier. Gjykata e Kurbinit përthithet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë⁴⁸.

Vlen të theksohet se këto vendime të KLGJ-së janë bazuar në nenet 42 (parimet e transferimit) dhe 44 (transferimi pa pëlqim) të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Sipas nenit 44, pika 1, gërma "b" të këtij neni, transferimi pa pëlqim realizohet kur pozicioni i magjistratit suprimohet për shkak të ndryshimeve në strukturën administrative ose në kompetencën tokësore të gjykatave ose prokurorive, pas kryerjes së një vlerësimi, bazuar në kriterë objektive dhe transparente. Pra kjo dispozitë, kushtëzon realizimin e transferimit, bazuar në kriterë objektive dhe transparente, të cilat i mungojnë vendimmarrjeve të KLGJ-së të analizuara në këtë

46 <https://klgj.al/wp-content/uploads/2023/01/VENDIM-Nr.-8-dat%C3%AB-18.01.2023-P%C3%8BR-FILLIMIN-E-PROCEDUR%C3%8BS-S%C3%8B-TRANSFERIMIT-T%C3%8B-GJYQTARES-%E2%80%A6-P%C3%8BR-SHKAK-T%C3%8B-SUPRIMIT-T%C3%8B-POZICIONIT-N%C3%8B-GJYKAT%C3%8BN-KU-%C3%8BSHT%C3%8B-CAKTUAR-N%C3%8B-M%C3%8BNYR%C3%8B-T%C3%8B-P%C3%8BRHERSHME.pdf>

47 [VENDIM-Nr.-9-dat%C3%AB-18.01.2023-P%C3%8BR-FILLIMIN-E-PROCEDUR%C3%8BS-S%C3%8B-TRANSFERIMIT-T%C3%8B-GJYQTARES-%E2%80%A6-P%C3%8BR-SHKAK-T%C3%8B-SUPRIMIT-T%C3%8B-POZICIONIT-N%C3%8B-GJYKAT%C3%8BN-KU-%C3%8BSHT%C3%8B-CAKTUAR-N%C3%8B-M%C3%8BNYR%C3%8B-T%C3%8B-P%C3%8BRHERSHME.pdf \(klgj.al\)](https://klgj.al/wp-content/uploads/2023/01/VENDIM-Nr.-9-dat%C3%AB-18.01.2023-P%C3%8BR-FILLIMIN-E-PROCEDUR%C3%8BS-S%C3%8B-TRANSFERIMIT-T%C3%8B-GJYQTARES-%E2%80%A6-P%C3%8BR-SHKAK-T%C3%8B-SUPRIMIT-T%C3%8B-POZICIONIT-N%C3%8B-GJYKAT%C3%8BN-KU-%C3%8BSHT%C3%8B-CAKTUAR-N%C3%8B-M%C3%8BNYR%C3%8B-T%C3%8B-P%C3%8BRHERSHME.pdf)

48 [VENDIM-Nr.-10-dat%C3%AB-18.01.2023-P%C3%8BR-FILLIMIN-E-PROCEDUR%C3%8BS-S%C3%8B-TRANSFERIMIT-T%C3%8B-GJYQTARES-%E2%80%A6-P%C3%8BR-SHKAK-T%C3%8B-SUPRIMIT-T%C3%8B-POZICIONIT-N%C3%8B-GJYKAT%C3%8BN-KU-%C3%8BSHT%C3%8B-CAKTUAR-N%C3%8B-M%C3%8BNYR%C3%8B-T%C3%8B-P%C3%8BRHERSHME.pdf \(klgj.al\)](https://klgj.al/wp-content/uploads/2023/01/VENDIM-Nr.-10-dat%C3%AB-18.01.2023-P%C3%8BR-FILLIMIN-E-PROCEDUR%C3%8BS-S%C3%8B-TRANSFERIMIT-T%C3%8B-GJYQTARES-%E2%80%A6-P%C3%8BR-SHKAK-T%C3%8B-SUPRIMIT-T%C3%8B-POZICIONIT-N%C3%8B-GJYKAT%C3%8BN-KU-%C3%8BSHT%C3%8B-CAKTUAR-N%C3%8B-M%C3%8BNYR%C3%8B-T%C3%8B-P%C3%8BRHERSHME.pdf)

seksion. Vlen gjithashtu në nënvizohet se magjistrati, të cilit i suprimohet pozicioni, sipas shkronjës “b”, pikës 1, të këtij neni:

- i. transferohet në pozicion në strukturën e re të së njëjtës shkallë, që ka në kompetencë tokësore gjykatën ose prokurorinë, pranë të cilës magjistrati ka ushtruar më parë funksionin, ose kur kjo nuk është e mundur;
- ii. gëzon të drejtën të zgjedhë për t’u transferuar në çdo pozicion, që është i lirë apo pritët të bëhet i lirë brenda gjashtë muajve nga momenti i shkurtimit të pozicionit, në gjykatë ose prokurori të të njëjtit nivel, të së njëjtës kompetencë lëndore.

Arsyetimi i vendimmarrjeve përbën gjithashtu një detyrim të parespektuar nga KLGJ sipas nenit 89, pika 2 e ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së drejtësisë”, sipas të cilit aktet administrative individuale të Këshillit, në lidhje me statusin e gjyqtarëve ose nëpunësve civilë gjyqësorë, bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, të shoqëruara me arsyetimin përkatës.

d) Rregullat e Brendshme të KLGJ

Ndër vendimet e kualifikuara nga KLGJ si akte të brendshme, gjatë muajit Dhjetor 2022, rezulton se janë hapur tre procedura, për tre vende të lira, për ngritjen në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë në fushën e së drejtës penale, në Gjykatën e Apelit Durrës në fushën e të drejtës penale dhe në Gjykatën e Apelit Korçë në fushën e të drejtës penale⁴⁹.

e) Rubrika në faqen zyrtare të KLGJ “Harta Gjyqësore” 50

Në faqen zyrtare të KLGJ është hapur një rubrikë e titulluar “Harta Gjyqësore”, e cila i shërben transparencës ndaj publikut lidhur me efektet e kësaj harte. Momentalisht, në këtë rubrikë është pasqyruar informacion lidhur me riorganizimin e gjykatave të apelit në të vetmen Gjykatë Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm, data e fillimit të funksionimit të saj dhe vendndodhja e godinës, çështjet që i transferohen kësaj gjykate dhe ato të cilat pavarësisht se transferohen nuk do të ndahen me short por do të vijojnë gjykimin nga trupat gjyqësore të gjykatave të shkrira, kërkesat që mund të paraqiten me anë të Zyrave të Shërbimit që ngrihen dhe funksionojnë pranë ish godinave të gjykatave të shkrira të apelit, etj.

49 Vendimet nr.502, 503 dhe 504, dt. 21.11.2022.

50 <https://klgj.al/harta-e-re-gjyqesore/>

6 Analizë e qëndrimeve të Gjykatave që preken nga riorganizimi i ri gjyqësor

KShH ka adresuar pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatave të Apelit në Republikën e Shqipërisë, që preken (shkrihen) për shkak të ri-organizimit gjyqësor territorial, një total prej 19 kërkesash për informacion. Kjo korrespondencë është realizuar me qëllim mbledhjen e të dhënave cilësore dhe statistikore sa i takon oponencës së brendshme të vetë gjykatave lidhur me organizimin e hartës së re gjyqësore, tashmë në proces zbatimi sipas VKM-së, nr. 495 dt. 21.07.2022.

Në kërkesat për informacion, interesi i KShH është përqendruar në tre drejtime kryesore që konsistojnë në vënien në dispozicion nga ana e gjykatave, të procesverbaleve të mbajtura përgjatë zhvillimit të mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve për secilën gjykatë për periudhën Shtator - Nëntor 2022, të korrespondencës zyrtare të mbajtur nga gjykatat me GNP e ngritur nga KLGJ si dhe dokumente të tjera ku përfshihen qëndrimet individuale të gjyqtarëve sa i takon rezervave të tyre lidhur me shkrirjen e gjykatave ku ushtrojnë funksionin (nëse ka patur).

Thënë sa më sipër, kërkesave të KShH, i janë përgjigjur në total 12 Gjykata, sipas pasqyrimit të të dhënave në tabelën Nr. 1.

TË DHËNA TABELARE				
Nr.	Institucioni	Mbledhje e Përgjithshme e gjyqtarëve (Procesverbale për periudhën Shtator-Nëntor 2022)	Korrespondencë me grupin e punës të ngritur nga KLGJ	Oponenca Individuale me shkrim
1	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat	JO (Ri-organizimi gjyqësor, jo rend dite)	JO	JO
2	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec	JO (Mosplotësim i kuorumit të anëtarëve)	PO - Komunikim me sektorin e Departamentit të Buxhetit pranë KLGJ	PO (qëndrim me shkrim nga 1 gjyqtar)

3	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë	JO (Ri-organizimi gjyqësor, jo rend dite)	JO	JO
4	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje	JO (Ri-organizimi gjyqësor, jo rend dite)	JO	JO
5	Gjykata Administrative Gjirokastrë	Nuk është përcjellë informacion	JO	Pa përgjigje
6	Gjykata Administrative Shkodër	PO (dakorësi unanime e gjyqtarëve mbi hartën e re gjyqësore)	Nuk ka informacion	JO (qëndrime verbale)
7	Gjykata Administrative Korçë	Pa përgjigje	PO Trajnim për punonjësit e sektorit të arkivës	JO (qëndrime në kuadër të tryezave konsultative)
8	Gjykata Administrative Durrës	JO (Ri-organizimi gjyqësor, jo rend dite)	Pa përgjigje	Pa përgjigje
9	Gjykata e Apelit Shkodër	JO (Ri-organizimi gjyqësor, jo rend dite)	JO	JO
10	Gjykata e Apelit Durrës	JO (Riorganizimi gjyqësor, jo rend dite)	JO	JO
11	Gjykata e Apelit Korçë	JO (Mosplotësim i kuorumit të anëtarëve)	JO	JO
12	Gjykata Administrative e Shkallës së parë Vlorë	JO (Ri-organizimi gjyqësor, jo rend dite)	Pa përgjigje	PO (Qëndrim alternativ)

Nga shqyrtimi dhe administrimi i shkresave kthim-përgjigje, ka rezultuar se vetëm nga ana e Gjykatës Administrative Shkodër, përgjatë zhvillimit të mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve të datës 02.12.2022, është diskutuar në mënyrë indirekte çështja e ri-organizimit gjyqësor. Nga procesverbali i vënë në dispozicion, del qartazi që pjesë e rendit të ditës në mbledhjen e kësaj date, është bërë kërkesa e KShH-së dhe se gjyqtarët pjesëmarrës në mbledhje kanë deklaruar verbalisht aty për aty, se kanë qënë dakord që në fillim me parashikimet e VKM-së Nr. 495 dt. 21.07.2022. Megjithatë kjo duket se është në kuadrin e dhënies së përgjigjës ndaj KShH-së, ndërkohë që nuk na është vënë në dispozicion ndonjë procesverbal i mbajtur në mbledhjet e mëparshme ku të jenë të dokumentuara qëndrimet e gjyqtarëve. Po ashtu nuk janë vënë në dispozicion qëndrime zyrtare me shkrim të gjyqtarëve apo personelit të gjykatës.

Ndërsa Gjykata Administrative Korçë, shprehet se nuk është zhvilluar asnjë mbledhje e gjyqtarëve ku të ketë qënë si rend dite, diskutimi mbi hartën e re gjyqësore. Sa i takon pikëpamjeve individuale të gjyqtarëve, është theksuar se ato janë shprehur në kuadër të konsultimeve publike të organizuara nga KLGJ dhe Ministria e Drejtësisë si në nivel qendror ashtu dhe në takimet ndërmjet gjykatave të së njëjtës shkallë. Por këto pikëpamje, nuk pasqyrohen qoftë edhe në mënyrë të përmbledhur në përgjigjen me shkrim drejtuar KShH-së, çka do t'i shërbente transparencës së qëndrimeve të mbajtura nga gjyqtarët e kësaj gjykate për hartën gjyqësore.

Sa më sipër, vlen të veçohet korrespondenca e mbajtur me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, ku pavarësisht se nuk ka asnjë mbledhje të gjyqtarëve ku të jetë diskutuar ri-organizimi territorial dhe funksional i gjykatave, me rëndësi paraqitet fakti që vetëm një prej gjyqtarëve të kësaj gjykate, i cili, nëpërmjet shkresës së datës 11.06.2021, ka paraqitur shqetësimin e tij me shkrim drejtuar Ministrisë së Drejtësisë. Në këtë shkresë është evidentuar se me shkrirjen e gjykatave sipas vlerësimit të kryer nga GNP, nuk respektohen parimet bazë për përcaktimin e kompetencës tokësore që lidhen me afërsinë e individit me gjykatën, uljen e kostove të shërbimeve për qytetin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve. Gjithashtu theksohet se referuar neneve 14 dhe 15 të ligjit Nr. 98/2016, gjykatat që janë pjesë e plan-projektit të miratuar, mund të operojnë funksionalisht mirë në formën e degëve, dhe se sipas ligjit, gjyqtarët mund të zëvendësohen me rotacion një herë në dy vjet. Këtij shqetësimi i është përgjigjur me shkresë, Ministria e Drejtësisë, e cila sqaron se në hartimin e projektit të hartës së re gjyqësore janë mbajtur parasysh specifikisht nenet 13, 14 dhe 15 të ligjit nr. 98/2016 “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*” ku përmbledhtazi Ministria pretendonte se është mbajtur parasysh garantimi i aksesit në drejtësi, numri i banorëve në raport me numrin e gjykatave, infrastruktura rrugore dhe kushtet e transportit, ngarkesa në gjykata, vendndodhja dhe përmasat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale si dhe nevojës për organizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave të paktën çdo 5 vjet. ***Edhe pse nga Ministria theksohet se, është realizuar një analizë e thelluar e të gjitha kritereve të parashikuara në ligj, duket se përgjigjia është e vakët dhe mbetet vetëm në nivel teorik pasi nuk mbështetet në përfundime empirike apo të testuara më parë.***


Interesant paraqitet qëndrimi me shkrim i adresuar nga Zv/Kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, qëndrimi i të cilit ka tiparet e një qëndrimi më tepër alternativ sesa shqetësues. Sakaq, qëndrimi i tij fokusohet në disa drejtime:

Kryesisht ndalet në sugjerimin e tij për mos-transferimin e gjykatës në të cilën ushtron funksionin, pranë godinave që ndodhen jashtë qytetit të Vlorës, pasi sipas tij, pas shkrirjes së Gjykatës së Apleit Vlorë sipas hartës së përcaktuar, mundësohet lirimi i godinës dhe ambienteve të kësaj gjykate dhe si e tillë mund të bëhet transferimi i Gjykatës Administrative Vlorë pranë këtyre ambienteve. Qëndrimi përforcobet me agrumentat që lidheshin me kushtet bashkëkohore të godinës të garantuara nga Bashkimi Europian, vështirësia e transferimit të dosjeve dhe materialeve relevante nga njëri qytet në tjetrin nëse Gjykata transferohet jashtë qytetit të Vlorës, si dhe ruajtja e statusit të nëpunësit civil të personave të punësuar pranë gjykatës pasi sipas ligjit, ato gëzojnë të drejtën e mostransferimit të tyre jashtë vendbanimit të tyre zyrtar, më shumë se 45 km.⁵¹

Në analizë të fundit, është vërejtur se objekt i rendit të ditës në mbledhjet e gjykatave të zhvilluara nga Gjykatat sipas tabelës Nr. 1, nuk ka qënë diskutimi lidhur me riorganizimin gjyqësor dhe sfidat që mbart në vetvete kjo reformë, por janë diskutuar më së shumti problematika që lidhen me veprimtarinë e përditshme të gjykatave. Në disa raste nuk është mundësuar zhvillimi i mbledhjeve për shkak të mosplotësismit të kuorumit të caktuar nga ligji, pasojë kjo e ardhur nga vakancat e krijuara nga vetingu.

51 Ligj Nr. 152/ 2013 “Për nëpunësin Civil”

Shqetësimi dhe pikëpamjet individuale të gjyqtarëve janë të paraqitura në % sipas grafikut të mëposhtëm.



Bibliografi:

Akte ndërkombëtare

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
Karta e të Drejtave Themelore të BE-së

Akte normative

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 (Amenduar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007, me ligjin nr. 9904, date 21.4.2008, me ligjin nr.88/2012, me ligjin nr.137/2015 dhe me ligjin nr.76/2016
Ligji Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.46/2021
Ligji Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”
Ligji nr.96/2016 “Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së drejtësisë”

Akte nënligjore

Vendimi nr.495, dt.21.07.2022, i Këshillit të Ministrave “Për ri-organizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”

Akte të Këshillit të Lartë Gjyqësor

Një hartë e re gjyqësore për shqipërinë, Raport vlerësimi nga KLGJ, Shtator 2021, i aksesueshëm në këtë link: <http://klgj.al/wp-content/uploads/2021/12/NJ%C3%8B-HART%C3%8B-E-RE-GJYQ%C3%8BSORE-.pdf>

Jurisprudencë

GJED, Znj. Baczó dhe Z.Vizsnyiczai kundër Raiffeisen Bank Zrt, i datës 12 Shkurt 2015, i publikuar në këtë link:
<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:62013CJ0567&from=EN>
GJED, C-619/10, Trade Agency Ltd v. Seramico Investments Ltd, 6 Shtator 2012
GJED, C-432/05, Unibet (London) Ltd and Unibet (International) Ltd v. Justitiekanslern, 13 Mars 2007
GJED, C-279/09, DEB Deutsche Energiehandels und Beratungsgesellschaft mbH v. Bundesrepublik Deutschland, 22 Dhjetor 2010
GJEDNJ, Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës
GJEDNJ, Philis kundër Greqisë
GJEDNJ, De Geouffre de la Pradelle kundër Francës
GJEDNJ, Stanev kundër Bullgarisë
GJEDNJ, Baka kundër Hungarisë

GJEDNJ, Aït-Mouhoub kundër Francës
 GJEDNJ, García Manibardo kundër Spanjës
 GJEDNJ, Lavents kundër Letonisë
 GJEDNJ, Sokurenko dhe Strygun kundër Ukrainës
 GJEDNJ, Buscarini kundër San Marino

Doktrinë

Manual për të drejtën Evropiane për Aksesin në Drejtësi, Agjensia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore dhe Këshilli i Evropës, 2016, i aksesueshëm në këtë link:

https://www.echr.coe.int/documents/handbook_access_justice_eng.pdf

Vështrim global në Aksesin në Drejtësi, Gjetjet e rezultuara nga projekti “Drejtësia në Botë” bazuar në një anketim të përgjithshëm të popullsisë në 101 vende të Botës, publikuar në vitin 2019, i aksesueshëm në këtë link:

<https://worldjusticeproject.org/sites/default/files/documents/ËJP-A2J-2019.pdf>

“Kadri për matjen e aksesit në drejtësi, duke përfshirë sfidat e veçanta me të cilat përballen gratë”, Autore, Teresa Marchiori, Specialiste e Reformës në Drejtësi, Raport i kontraktuar nga UN Women në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, i aksesueshëm në këtë link:

<https://rm.coe.int/1680593e83>

CEPEJ, Udhëzues mbi Organizimin dhe Aksesueshmërinë e Ambienteve të Gjykatës, Dhjetor të 2014, i aksesueshëm në këtë link <https://rm.coe.int/16807482cb>

CEPEJ, Udhëzues mbi krijimin e hartave gjyqësore (i vitit 2013), i aksesueshëm në këtë link <https://rm.coe.int/european-commission-for-the-efficiency-of-justice-cepej-revised-guidel/168078c492>

Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022, i aksesueshëm në këtë link https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en

Oponencë ndaj Propozimeve për Hartën e Re Gjyqësore për Shqipërinë, 11 Shkurt 2022, hartuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe nënshkruar nga 9 organizata të shoqërisë civile, e aksesueshme në këtë link:

https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/02/Opinion-ligjor_Raporti-i-Vleresimit-per-Harten-e-re-Gjyqesore.pdf

Judicial Reforms ‘Under Pressure’: The New Map/Organisation of the Portuguese Judicial System, July 2018

(Reformat në Drejtësi “Nën Presion”, Harta e re gjyqësore/organizimi në sistemin gjyqësor në Portugali, Korrik 2018), i aksesueshëm në këtë link

https://ëëë.researchgate.net/publication/326686070_Judicial_Reforms_%27Under_Pressure%27_The_Nëë_MapOrganisation_of_the_Portuguese_Judicial_System

The transition to a democratic Portuguese judicial system: (delaying) changes in the legal culture*
 João Paulo Dias

(Tranzicioni drejt një sistemi gjyqësor demokratik në Portugali: vonesat, ndryshimet në kulturën Ligjore, artikull për revistën juridike ndërkombëtare të Universitetit të Kembrixhit), i aksesueshëm në këtë link

[https://estudogeral.uc.pt/bitstream/10316/33099/1/The%20transition%20to%20a%20democratic%20Portuguese%20judicial%20system%20\(delaying\)%20changes%20in%20the%20legal%20culture.pdf](https://estudogeral.uc.pt/bitstream/10316/33099/1/The%20transition%20to%20a%20democratic%20Portuguese%20judicial%20system%20(delaying)%20changes%20in%20the%20legal%20culture.pdf)

Comparative study of the reforms of the judicial maps in Europe, SPSC, 2012
(Studim krahasimor për reformat në hartat gjyqësore në Evropë), i aksesueshëm në këtë link
<https://rm.coe.int/comparative-study-of-the-reforms-of-the-judicial-maps-in-europe/168078c53a>

Akte të KLGJ-së

Urdhëri nr.80, dt.28.07.2022 i Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor
Vendimi nr. 505, datë 21.11.2022 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të juridiksionit të përgjithshëm”
Vendimi nr.554,datë 29.12.2022 “Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore
Vendimi nr. 556, datë 29.12.2022 “Mbi miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshtatjen e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm”
Vendimi nr. 553, datë 29.12.2022 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm”
Vendimi nr. 555, datë 29.12.2022 ”Për rishpërndarjen e numrit të pozicioneve të punës në Gjykatën e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në gjykatat e rretheve gjyqësore”
Vendim nr. 557, datë 29.12.2022 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisioneve të ristrukturimit
Vendimi nr.8, dt.18.01.2023 “Për fillimin e procedurës të transferimit të gjyqtarëve për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme”.
Vendimi nr.9, dt. 18.01.2023 “Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarëve për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme”
Vendimi nr.10, dt.18.01.2023 “Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarëve për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme”
Vendimet nr.502, 503 dhe 504, dt. 21.11.2022

Të tjera

Deklarata e KShH e dt.14 Qershor 2021, e aksesueshme në këtë link:
<https://ahc.org.al/njoftim-per-shtyp-aksesi-ne-drejtesi-prioriteti-me-madhori-hartes-se-re-gjyqesore/>

